

Dalës-Izlazne

Nr. 11-237
Br.

Data 21.03.2018
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosova

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Datë/Data/Date	01.03.2018
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunes z.Xhafer Gashi
Për/Za/To:	Kryesusin e Kuvendit Komunal z.Burim Gerguri
CC:	Kuvendit Komunal Obiliq
Tema/Subjekat/Subject:	Raporti financiar për vitin 2017



Të nderuar !

Të nderuar deputetë, në mbështetje të nenit 58, paragrafi (j) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 72, paragrafi 1.10 të Statuti të Komunës ju sjellim:

Raportin financiar për vitin 2017 , raporti ndahen në dy pjesë 1. Raporti i financiar dhe raporti i zyrës së prokurimit .

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E AD. STRATËS PËRQJITHSHE
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Delës-izlazna

Nr. 11-237
Br.

Data 21.03.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Të nderuar deputetë, në mbështetje të nenit 58, paragrafi (j) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 72, paragrafi 1.10 të Statuti të Komunës ju sjellim:

RAPORTIN FINANCIAR TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2017

Obiliq 2018

Hyrje

Raporti financiar i Kryetarit të Komunës, është pasqyrë e qartë e punës, angazhimit dhe përkushtimit të Kryetarit, dhe stafit të tij.

Obligimet që derivojnë nga Ligjet në fuqi dhe aktet e tjera që rrjedhin nga Ligjet, janë detyrime të ekzekutivit, jo vetëm në raport me qytetarët por edhe me përcaktimet ligjore dhe Kuvendin. Raporti që keni në dorë, pasqyron në vija të trasha atë që ekzekutivi ka arritur ta realizoi gjatë vitit 2017.

Këto të arritura mund të mos përfaqësojnë edhe kënaqshmërinë tonë, por janë pasqyrë e qartë e asaj që është punuar gjatë këtij viti duke pasur parasysh rrethanat politike dhe sociale në vend, mbajtjen e dy palë zgjedhjeve si dhe problemet funksionimit në nivelin qendror direkt apo indirekt kanë arritur të influencojnë edhe në punën e Komunës tonë.

Është relevante të potencohet që viti 2017 i ka vënë caqet afatgjate të zhvillimit të Komunës. Implementimi i Ligjit për Obiliqin, realizimi i projektit të ngrohjes nga avujt e KEK-ut, funksionalizimi i Zonës Industriale si dhe realizimi i hartave zonale, janë katër shtyllat kryesore përmbushja apo realizimi i të cilave jo vetëm që është parakusht për zhvillim të Komunës, por lehtëson jashtëzakonisht shumë jo vetëm gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve të Komunës sonë, por ndikon shumë edhe në gjendjen mjedisore. Paralelisht me këto synime, ne do të punojmë në vazhdimësi që t'i përmbushim kërkesat që qytetarët kanë ndaj Komunës.

Për fund besojmë fuqishëm që jemi futur në pjesën finale të investimeve në disa sektor, dhe ky mandat do të rezultojë me mbylljen e tyre si në infrastrukturë rrugore ashtu edhe në arsim, shëndetësi, kulturë-sport etj.

PËRMBAJTJA

1. Hyrja.....	2
2. Përmbajtja.....	3
3. Raporti i Kryetarit të Komunës.....	4
4. Drejtoria e Administratës së Përgjithëshme.....	5
5. Drejtoria Arsimit.....	7
6. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.....	11
7. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	14
8. Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër.....	15
9. Drejtoria e Inspektionit.....	16
10. Drejtoria e Infrastrukturës Lolale.....	21
11. Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit.....	22
12. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.....	25
13. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	35
14. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.....	53

RAPORTI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Deputetë të nderuar të Kuvendit Komunal, viti 2017 është shoqëruar me sfida, punë e angazhime të mëdha për Komunën tonë.

Kërkesat e shumta të qytetarëve tanë për infrastrukturë, shkolla, rrymë, ujë, trotuar, rrugë, ndriçim etj, kanë bërë që si ekzekutiv të punojmë maksimalisht jo vetëm në përmbushjen e tyre, por duke i ditur edhe kufizimet tona buxhetore, të mundohet t'i vej edhe prioritete sa i përket përmbushjes apo realizimit të tyre.

Gjatë vitit 2017, një pjesë e madhe e punëve që kanë qenë të projektuara janë përmbushur, projekte të tjera të cilat kanë qenë të projektuara të realizohen për një periudhë kohore më shumë se një vjeçare janë afër përfundimit si dhe kemi edhe fillimin e realizimit të projekteve të tjera.

Gjatë këtij viti është arritur të përfundohet ndërtimi i shkollës në fshatin Lajthishtë, tani nxënësit e kësaj shkolle zhvillojnë procesin mësimor në objektin e ri të shkollës. Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e urës mbi lumin 'Sitnica', ndërtimi i vrazhdë i shtëpisë së kulturës ka përfunduar, parku i qytetit nën hekurudhë, projekt i mbështetur nga Korporata Energjetike e Kosovës është realizuar e shumë projekte të tjera infrastrukturore. Pas kërkesave të shumta që i kemi drejtuar Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, realizimi i projektit të pastrimit të lumit "Sitnica", është në një fazë të mirë të realizimit. Tashmë një pjesë e mirë e tij veç ka përfunduar dhe përfundimi i këtij projekti do të shmangë shumë probleme të vërshimeve për banorët që jetojnë përreth këtij lumi si dhe për tokat bujqësore.

Është e rëndësishme të potencohet që ka filluar edhe ndërtimi i shkollës në fshatin Raskovë, një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për përmylljen e investimeve në këtë sektor. Ndërtimi i "Qendrës së Regjimit Civil" është në fazën finale dhe shumë shpejt do të bëhet funksionalizimi i saj.

Stadiumi "Agron Rama", tashmë ka kaluar në pronësi të Komunës, ridefinimi i pronësisë së kësaj hapësire do t'i hap rrugë investimeve milionëshe nga FIFA.

Me komunën e Vushtrrisë kemi nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për pastrimin e lumit "Llap", realizimi i këtij projekti ka filluar, por për shkak të kushteve atmosferike nuk është arritur të përfundohet.

I potencuam disa nga projektet kapitale që janë zhvilluar gjatë këtij viti pa u lëshuar në detaje në sektor të ndryshëm.

Si Kryetar i komunës, gjatë tërë vitit kalendarik, jam angazhuar siç më ngarkojnë ligjet në fuqi që të punoj në shërbim të së mirës së përgjithshme.

Shtrirja dhe thellimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror si dhe organizata të ndryshme të huaja dhe vendore me qëllim të tërheqjes së donacioneve të ndryshme, ka qenë ndër prioritetet e qeverisjes sime.

Dëshmia që kemi dyfishim të investimeve në sfera të ndryshme tregon për efikasitetin e ekzekutivit në këtë rrafsh.

Deputet të nderuar, nuk do lëshohem më hollësisht në sfidat dhe të arriturat gjatë këtij viti, ngaqë dua të lë më shumë hapësirë për pjesën ku drejtorët e resorëve gjegjës do të ofrojnë dëshmi për punët dhe angazhimet e tyre.

Çdo gjë që ngjallë interesimin e juaj, e që nuk është përfshirë në këtë raport, ju lutem të kërkonit informata shtesë.

Duke shprehur në mirëkuptimin e juaj, shpresoj dhe uroj në bashkëpunim edhe në vitin 2018.

Më poshtë do të gjeni raportet e drejtorëve të drejtorive komunale.

Ju faleminderit!

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME

Drejtoria e administratës në kuadër të kompetencave të saj, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim të organeve të tjera të administratës, por edhe ofrimin e shërbimeve administrastive për qytetarët e komunës së Obiliqit.

Përgjigjja në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar Kryetarit, bordit dhe drejtorive, po ashtu kemi bërë lëshimin e vërtetimeve për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, gjithsej janë lëshuar 15- vërtetime.

Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së prokurimit dhe njërive kërkuese .
Sektori kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve të tij si dhe mbikëqyrë punët në QSHQ .

Kuvendi Komunal, ka mbajtur: (11) mbledhje të rregullta, (1) mbledhje solemne, (1) mbledhje inauguruese dhe (1) mbledhje të jashtëzakonshme .

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur (9) seanca, po aq seanca ka mbajtur edhe Komiteti për Komunitete (9).

KKSB-Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur (4) mbledhje.

Gjatë periudhës raportuese kemi pasur (9) kërkesa për qasje në dokumentet publike- zyrtare prej të cilave (9) janë të aprovuara.

Zyrtari për përkthim Shqip-Sërbisht dhe anasjelltas i kryen punën e vet ashtu si i bëhen kërkesat nga drejtoritë dhe të tjerët.

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Ka mbajtur takime të rregullta me: ABGJ (ZKM), divizionin për të drejtat e njeriut në MAPL, OJQ Aureola, organizates "Gratë për gratë", pjesëmarrja në promovimin e aplikacionit për raportimin seksual "Ec Shlirë" i lansuar nga rrjeti i grupit të grave, me KFOR-in, USAID-in, OSCE, et,

Vlenë të cekët se kemi pranur ankesa nga komuniteti RAE, ku kanë kërkuar ndihmë në regjistrim pranë ofiqarisë dhe ankesa për shkelje të drejtës për shfrytëzim të rrymes, kategoria sociale ndaj KEDS-it.

Zyrtarët e kësaj njësie kanë marrë pjesë në shumë seminare lidhur me trajtimin e temave nga lëmia për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, në mbledhjet e KK-së dhe KKSBB-së si dhe pjesëmarrja ne komisione të ndryshme.

Zyra e arkivës

Zyra e Arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, gjatë vitit 2017, janë proceduar (2804) lëndë.
Ekspeditimi i postës 221 lëndë jashtë komunës përmes postës.
Zyrtari për saktësime ka proceduar 288 lëndë për saktësime.

Zyra e Pranimit (Shërbim për qytetarë)

Punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre, Këto punë(lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, për periudhën raportuese, sipas drejtorive janë kryer:
29.145 lëndë.

Zyra e ofiqarisë

Në këtë zyre gjatë periudhës raportuese 01/01/2017-31/12/2017 janë kryer:

Ekstrakti i lindjes	12652
Certifikata e lindjes	4163
Certifikata e martesës	2799
Certifikata e vdekjes	709
Certifikata e vendbanimit	936
Certifikata e bashkësisë familjare	2398
Certifikata e gjendjes martesore	546
Certifikata e shtetësisë	161
Vërtetim nga arkiva	262

Gjithësej: 24709

Numri i qytetarëve që kanë kaluar regjistrin qendror	1403
--	------

Shefi i sektorit në bashkëpunim me anëtarët tjerë të Komisionit, bënë përgatitjen e aktvendimeve për korigjimin- **46 aktvendime**, ndërrimi emrit, mbiemrit- **6 aktvendime** si dhe regjistrimet e më vonshme ne LAL- **9 aktvendime**, LAV - **44 aktvendime**- totali **105**.
Edhe zyrtari i IT-s, gjatë kësaj periudhe kohore i ka kryer të gjitha detyrat në përputhje me kërkesat dhe nevojat e zyrtarëve komunal.

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit duke u mbështetur në planin vjetor të punës, orientoi tërë aktivitetet e saj në ngritje të cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxëniet si synimin më parësor, duke mos lënë anash edhe *objektivat* tjera që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës shkollore, duke krijuar një ambient të këndshëm që është i përshtatshëm për të gjithë, ku do të vie në shprehje mësimdhënia dhe mësimnxënia sipas kriterëve avancues të një shkolle moderne.

DKA vlerëson, se synimi parësor, ngritja e cilësisë është duke u realizuar me sukses, duke arritur rezultate të arritshmërisë në të dy nivelet e shkollimit në Komunën e Obiliqit, mbi mesataren e rezultateve në nivel të Republikës së Kosovës, që është një tregues i besueshëm për nivelin e cilësisë në të dy nivelet e shkollimit, atë fillor dhe të mesëm në komunën e Obiliqit.

Për ta realizuar objektivën „përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës shkollore”, janë paraparë dhe realizuar me sukses projektet për vitin 2017 .

Projektet e realizuara në DA -2017:

- SHFMU „Fazli Grajqevci”, Lajthishtë
Ndërtimi i Shkollës në Lajthishtë

- SHFMU „Hasan Prishtina”, Raskovë
Fillimi i ndërtimit të shkollës (investim i MASHT-it)

- SHFMU „Naim Frashëri” Breznicë
Instalimi i sistemit të ri të ngrohjes qendrore, mbushja e sistemit të ngrohjes me 150l antifriz, ndërtimi i tri krojeve (dy krojeve fushore dhe një në sallën e arsimitarëve), ndërtimi i derës së hyrjes (erëmbrojtësi).

- SHFMU „Naim Frashëri”, paralelja e ndarë në Kozaricë
Shtrurja (organizimi) i oborrit të shkollës në kubëza, mbushja e sistemit të ngrohjes me 50l antifriz.

- SHFMU „Hasan Prishtina”, Milloshevë
Instalimi (ndërtimi) i njërit nga tri kaldatë ekzistuese të ngrohjes qendrore, ngjyrosja e dy etazheve të hapësirës së mbrendëshme të shkollës, instalimi i sistemit të kamerave, renovimi i mobiluarit të parkut, paisja me dy makina për pastrimin e pllakave të dyshemesë, një kositëse bari për mirëmbajtjen e parkut, renovimi i nyjeve sanitare, instalimi i ventilatorit për ajrosje në etazhën e tretë të shkollës.

- SHFMU „Pandeli Sotiri”, Obiliq
Renovimi i sistemit të kamerave, paisja me makinë për pastrimin e pllakave të dyshemesë, renovimi i nyjeve sanitare, paisja me mjete të punës për shtëpiakun.

- SHMLP „Ismail Dumoshi”

Renovimi i sistemit të kamerave, hapja e mureve të mbrendëshme të koridoreve dhe montimi i dritareve për ndriçim shtesë, paisja me dy makina për pastrimin e pllakave të dyshemesë dhe një makinë për kositjen e barit për mirëmbajtjen e parkut, renovimi i nyjeve sanitare.

- Gjimnazi „17 Shkurti”

Renovimi i sistemit të kamerave, hapja e mureve të mbrendëshme të koridoreve dhe montimi i dritareve për ndriçim shtesë, renovimi i nyjeve sanitare.

- SHFMU „Ibrahim Rugova”, Obiliq me paralelet e ndara.

Paisja me kositëse bari për mirëmbajtjen e parqeve të shkollave, paisja me makinë për pastrimin e pllakave, instalimi i dy kaldave të reja në sistemet e ngrohjes, mbushja e dy sistemeve të ngrojeve me nga 100l antifriz, në dy shkolla paralele të ndara në Mazgitin e Ulët dhe në Mazgitin e Lartë.

- SHFMU „Abrurrahman Gërguri”, Dardhishtë

Instalimi (ndërrimi i kaldasë së vjtër) i kaldasë në sistemin e ngrohjes, mbushja e sistemit të ngrohjes qendrore me 100l antifriz.

- SHFMU „Migjeni”, Siboc me paralelet, në Shipitullë dhe Graboc

Shtrurja e shtegut rreth shkolle në kubëza(Siboc), ndërrimi i dritareve dhe dyerve Shipitullë, instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore, mbushja e sistemit të ngrohjes në Graboc.

- IP „Rrita Jonë”

Instalimi sistemit të kamerave, shtrurja e platformës para institucioni në kubëza, blerja e frigorifeit, blerja e makinës për pastrimin e dyshemesë.

Angazhimet dhe aktivitete e zhvilluara:

- Kremtimi i Ditës së Mësuesit – 7 Marsi 2016
- Ndarja e Çmimit “Mësimdhënës i dalluar” 2016
- Ndarja e pjesës së dytë të bursave, për 50 studentë, dhe 23 nxënës.
- Shpallja e konkurseve dhe organizimi i intervistave
- Monitorimi i shetitjeve të organizuara për kl. e IX-ta
- Organizimi i ekskursioneve për maturant
- Hartimi i projekteve kapitale për këtë vit dhe fillimi i realizimit të tyre
- Organizimi i Testit të Arritshmërisë 2017
- Pjesëmarrja në organizimin e Testit të Maturës Shtetërore 2017
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nx. në kl. e dhjetë.
- Shpallja e konkursit për stafin Drejtues të shkollave
- Trajtimi i konkurseve për stafin drejtues dhe mësimdhënës për shkolla.
- Organizimi i Testit të Maturës për afatin e gushtit 2017.
- Përgatitjet e shkollave për fillimin e vitit shkollor 2017/2018
- Ndarja e pjesës së parë të bursave për vitin shk.2017/2018, për 23 nxënës dhe 50 student
- Pranimi në menagjim i projekteve kapitale të realizuara nëpër shkolla.

Suksesi i nxënësve në gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018
Niveli i shkollimit, SHFMU 1-5

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënëseve	Suksesi pozitiv												Gjithsej me nota të			Të pa notuar		Numri i mungesave	
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaltëshëm		Gjithsej me nota pozitive		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%									Nr
1	20	346	216	62.43	66	19.08	39	11.27	23	6.647	344	99.42	0	0	1	0.3	1807	347	2154		
2	19	346	220	63.58	62	17.92	45	13.01	15	4.335	342	98.84	4	1.156	0	0	1498	421	1919		
3	20	366	211	57.65	84	22.95	43	11.75	13	3.552	351	95.9	12	3.279	2	0.5	2169	299	2468		
4	20	314	144	45.86	80	25.48	67	21.34	15	4.777	306	97.45	10	3.185	0	0	1511	566	2077		
5	20	350	170	48.57	103	29.43	50	14.29	11	3.143	334	95.43	16	4.571	0	0	2167	313	2480		
GJ	99	1722	961	55.81	395	22.94	244	14.17	77	4.472	1677	97.39	42	2.439	3	0.2	9152	1946	11098		

Suksesi i nx. në gjysëmvetorin e parë të vitit shk. 2017/2018, niveli i shkollimit, SHFMU 6-9

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv						Suksesi i pamjaftueshëm						Numri i mungesave												
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithësi me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithësi me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme		Të pa arsyeshme		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr
6	18	327	77	23.55	74	22.63	74	22.63	16	4.893	241	73.7	24	7.3	22	6.7	39	12	85	25.99	1	0.306	1480	499	1979		
7	18	368	94	25.54	91	24.73	64	17.39	10	2.717	259	70.38	27	7.3	20	5.4	63	17	110	29.89	0	0	1541	599	2140		
8	19	343	83	24.2	79	23.03	77	22.45	14	4.082	253	73.76	31	9	23	6.7	40	12	94	27.41	0	0	2340	1115	3455		
9	19	379	94	24.8	86	22.69	74	19.53	4	1.055	258	68.07	33	8.7	25	6.6	57	15	115	30.34	1	0.264	2541	1317	3858		
GJ	74	1417	348	24.56	330	23.29	289	20.4	44	3.105	1011	71.35	115	8.1	90	6.4	199	14	404	28.51	2	0.141	7902	3530	11432		

Suksesi i nx. në gjysëmvetorin e parë të vitit shk. 2017/2018, niveli i shkollimit, SHMLP, GJIMNAZI

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv						Suksesi i pamjaftueshëm												Numri i mungesave						
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithësi me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithësi me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme		Të pa arsyeshme		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr
10	13	286	8	2.797	31	10.84	51	17.83	11	3.846	101	35.31	36	13	30	10	103	36	169	59.09	18	6.2	1066	78	2344		
11	9	258	30	11.63	30	11.63	36	13.95	8	3.101	104	40.31	39	15	22	8.5	90	35	151	58.53	2	0.7	1870	15	3585		
12	12	243	30	12.35	41	16.87	28	11.52	5	2.058	104	42.8	25	9.5	30	12	66	27	119	48.97	19	7.8	1500	2	2312		
GJ	34	787	68	8.64	102	12.96	115	14.61	24	3.05	309	39.26	98	12	82	10	259	33	439	55.78	39	5.6	4436	05	8241		

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e njohur më posht si DBZHR duke u mbështetur në kompetencat të cilat derivojn nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe statuti i Komunës ka realizuar detyrat e hartuara për vitin 2017. Në plan programin e punës së Drejtorisë për periudhën një vjeçare, DBZHR ka zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme. Drejtoria ka realizuar aktivitete të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e ekonomive të vogla familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje me konstruktive në këtë lëmi.

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm potencial për zhvillim ekonomik, duke u mbështetur në këtë ka filluar përkrahja e fermerëve me grandin "Përkrahja me pemë të imta – mjedër"; dhe vazhdimi i projektit me pemë të imëta luleshtrydhe-dredhëz. Drejtoria në këtë periudhë ka bërë vazhdimisht monitorimin e pyjeve të Komunës.

Kërkesë për prerje të pyjeve private ka qenë dy.

Drejtoria ka organizuar 7 këshillime me fermerët në koordinim me MBZHR, dhe 1 trajnim për nënpunës.

Stafi i DBZHR ka freskuar statistikat e kulturave bujqësore dhe fermerët që merren me varietete të ndryshme.

Numri i fermerëve në lëmin e bujqësisë është 924.

Në tabelë janë paraqit të dhënat për tokën bujqësore dhe sipërfaqet e mbjellura.

Kategori të tokës	Sipërfaqja e tokës	Kulturat bujqësore	Sipërfaqja e të mbjellurave drithëra kokërr
Tokë bujqësore	5519.32 ha	Grurë	815.6 ha
Tokë e punueshme	3413.53 ha	Misër	680 ha
Kullota	74.39 ha	Elb	14 ha
Livadhe	326.78 ha	Thekër	0 ha
Djerrina	29.05 ha	Tërshërë	15 ha
Tokë e zhveshur	190.3 ha	Fasule	12.77 ha
Të tjera	226.46 ha		

Në tabelë është paraqitur ndarja e subvencioneve për vitin 2017.

Emërimi i projekteve për subvencionim	Shuma e subvencioneve	Bashkëfina nçimi	Shuma totale
Projekti - Mbështetje fermerëve me fidane pemë të imta mjedër	9,984.00 €	2,287.60 €	12,271.60 €
Projekti me varietetin luleshtrydhe-dredhëz	6,723.00 €	1,680.00 €	8,403.00 €

industrial Senga			
Projekt - Ngritja e serave 50 m ² për perimkultur	14,308.80 €	3,885.20 €	18,194.00 €
Projekt - Ngritja e serave 50 m ² për perimkultur. Faza e dytë	20,620.18 €	4,744.40 €	25,364.58 €
Projekt - Dhi Qumështore	7,500.00 €		
Projekt - Farë gruri	12,870.00 €		
Projekt - Naftë për fermer	4,290.00 €		
Projekt - Mbështetje fermerët me ushqim (pogaçe) për bletë	5,967.00 €		
Mbështetje për fermer	950.00 €		
Totali	83,212.98 €	12,577.20 €	95,790.18 €

Në Drejtorinë e Bujqësisë ka pasur gjashtë kërkesa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, tri janë përcjellur në MBPZHR. Janë refuzuar tri kërkesa për shndërrimin e tokës. Numri i kërkesave në DBZHR.

Nr i kërkesave	Kërkesat nga qytetarët			
	Të shqyrtuara	Në shqyrtim	Refuzuar	Pezulluar
140	129	6	3	2

Fermërit përfitues nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të cilët kanë aplikuar përmes DBZHR janë paraqitur në tabelë.

Numri i fermerëve	Grurë	Misër	Patate	Pemëtarë	Lopë	Dele	Bletë	Perime
688	815.6 ha	680 ha	68.85 ha	40.85 ha	684	841	2687	89.52 ha

Për qumësht kanë aplikuar:

14 fermer me sasi 95,323.00 litra qumësht që është subvencionuar nga MBPZHR për tre mujorin e parë përmes DBZHR.

15 fermer me sasi 140,549.00 litra qumësht, që është subvencionuar nga MBPZHR për tremujorin e dytë përmes DBZHR.

15 fermer me sasi 121,865.00 litra qumësht, që është subvencionuar nga MBPZHR për tremujorin e tretë përmes DBZHR. Me datën 07.07.2017 është krijuar shtabi për korrijeshirje të cilët kanë bërë monitorimin e fushatës së korrijeshirjeve dhe marrjen e informacioneve se si po rrijnë të korrurat në territorin e komunës. Rendimenti mesatar për një ha ka qenë 3.5 tonë.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA

1. Projekti - Pagesa direkte për fidane të mjedrës
Kemi përzgjedhur 12 fermerë për mbjellje të fidaneve mjedër me sipërfaqe 2.4 ha të cilët i ka mbështetur USAID me sistem pikë pikë.

Ftesa publike është bërë me datën 23.02.2017 dhe ka përfunduar me datën 10.03.2017.
Ky projekt është financuar me garantim të pikës grumbulluese për fermerët përfitues.
Nga numri i përgjithshëm që kanë aplikuar për mjedër 13, përfitues janë 12 fermerë, të cilët i kanë plotësuar kriteret e parapara sipas "Ftesës Publike" për aplikim, një është tërhequr.
Kërkesa për ndarjen e mjeteve është bërë pasi fermerët kanë dorëzuar faturën e rregullt të bashkangjitur me kupon fiskal.

2. Projekt-Pagesa direkte për fidane dredhëz industriale "SENGA"
Ftesa publike është bërë me datë 23.02.2017 deri me datën 10.03.2017.
Për këtë projekt aplikues janë 10, përfitues janë 9 fermer për fidane dredhëz, një është tërhequr.
Në këtë projekt financues është USAID me sistem pikë pikë dhe foli.
Kërkesa për ndarjen e mjeteve është bërë pasi fermerët kanë dorëzuar faturën e rregullt të bashkangjitur me kupon fiskal.

3. Projekt - "Ngritja e serave tunel 50 m²".
Për këtë projekt kanë aplikuar 151 kandidatë, përfitues nga ky projekt janë 44 aplikus.
Një përfitues është tërhequr nga mos mundësia e pagesës për shkak të participimit.
Ftesa për aplikim është bërë me datë 22.02.2017 dhe ka përfunduar me datën 09.03.2017.
Të gjithë përfituesit në këto projekte kanë nënshkruar marrëveshje nga të cilat rrjedhin detyrimet.

4. Projekt - "Dhi qumështore"
Për këtë projekt kanë aplikuar 50 kandidatë, përfitues nga ky projekt janë 31 aplikus, një është tërhequr.
Ftesa për aplikim është bërë me datë 12.07.2017 dhe ka përfunduar me datën 27.07.2017.
Të gjithë përfituesit në këto projekte kanë nënshkruar marrëveshje nga të cilat rrjedhin detyrimet.

5. Projekt - "Pagesa direkte për farë gruri dhe derivate të naftës"
Për këtë projekt kanë aplikuar 144 kandidatë, përfitues nga ky projekt janë 143 aplikus.
Ftesa për aplikim është bërë me datë 15.09.2017 dhe ka përfunduar me datën 25.09.2017.

6. Projekt - "Ngritja e serave tunel 50 m²" faza e dytë
Për këtë projekt kanë aplikuar 159 kandidatë, përfitues nga ky projekt janë 58 aplikus.
Ftesa për aplikim është bërë me datë 15.09.2017 dhe ka përfunduar me datën 13.10.2017.
Të gjithë përfituesit në këto projekte kanë nënshkruar marrëveshje nga të cilat rrjedhin detyrimet.

7. Projekt - "Mbështetje fermerëve me ushqim (pogaçe) për bletë"
Për këtë projekt kanë aplikuar 68 bletarë, përfitues nga ky projekt janë 68 bletarë.
Ftesa për aplikim është bërë me datë 02.11.2017 dhe ka përfunduar me datën 12.11.2017.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2017 ka punuar maksimalisht që në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë së saj, të përfshijë sa më shumë aktivitete kulturore e sportive veçanërisht. Duke i cilësuar si shumë të rëndësishme aktivitetet në fushën e kulturës, sportit e aktiviteteve të tjera, si drejtori kemi vlerësuar dhe punuar që të gjitha kapacitetet tona njerëzore e materiale t'i vejmë në shërbim të tyre.

Numri i aktiviteteve kulturore gjatë vitit 2017 ka qenë dukshëm më i lartë se në vitet e mëhershme, madje edhe krahasuar me tre vitet e mëhershme. Po ashtu, edhe numri i klubeve sportive, OJQ-ve, Shoqërive Kulturoro-Artistike, sportistëve, autorëve etj që janë përkrahur financiarisht nga DKRS, ka qenë dukshëm më i lartë.

Përkrahja dhe hapësira e ofruar për të rinjtë, ka bërë që kënaqëshmëria me aktivitete letrare e kulturoro-sportive të jetë në nivel shumë të lartë.

Tashmë është shndërruar në moto të DKRS-së, që sa më i madh të jetë numri i rinjve në hapësira të destinuara për zhvillim të aktiviteteve kulturore-sportive, aq më i avancuar do të jetë niveli kulturor e sportiv i tyre në njërin anë dhe në anë tjetër i gjithë ky organizim do të rezultojë me ulje të shkallës së numrit të incidenteve.

Një gjë të tillë e dëshmojnë edhe vlerësimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017.

Këto dhe shumë aktivitete të tjera, DKRS ka arritur t'i realizojë me një buxhet simbolik. Gjatë këtij viti, DKRS ka organizuar manifestime e aktivitete të ndryshme. Thuajse në çdo muaj të vitit 2017 kemi pasur minimum një aktivitet nga ato që janë në kompetencë të saj.

"17 Shkurti", "Dita e Çlirimit", "Ditët e Diasporës", "28 Nëntori" e shumë aktivitete të tjera për nder dhe respekt të dëshmorëve e martirëve të Komunës sonë, janë aktivitete që janë organizuar së bashku edhe me shumë shfaqje, ekspozita e promovime të librave të ndryshëm.

Po ashtu janë organizuar edhe fushata vetëdijësuese në sfera të ndryshme të shoqërisë sonë.

Është punuar shumë në studimin dhe analizën që i kemi bërë gjithë hapësirave ku i kemi të vendosura bustet apo lapidarët e ndryshëm të dëshmorëve e martirëve tanë. Gjendja e tyre jo e mirë, na ka shtyrë që të fillojmë me ri-rregullimin e tyre.

Në vitin 2017 kemi intervenuar dhe e kemi ndërtuar përmendoren dhe hapësirën përreth, në nder të rënjes së "Dëshmorëve të Familjes Rama".

Është rregulluar edhe pjesa ku është i vendosur busti i heroit "Aziz Zhilivoda" së bashku edhe me sheshin dhe kështu do të trajtohen gjithë këto hapësira.

Më lartë i përmendëm disa prej aktiviteteve që ne i cilësojmë si kryesore që i zhvillojmë brenda një viti kalendarik, por për të qenë më specifik, më poshtë ju ofrojmë edhe një pjesë të aktiviteteve tjera që ne si drejtori i kemi realizuar gjatë vitit 2017:

1. "Qershori, muaji i Krenarisë" - Dita e Çlirimit të Komunës
2. "Ditët e Mërgimtarëve"
3. "Java Rinore"
4. Kros pranveror
5. "Dita ndërkombëtare kushtuar sportit për zhvillim dhe paqe"
6. "Dita ndërkombëtare e Çlirimit të të Burgosurve"
7. "Dita Ndërkombëtare Kundër Duhanit"
8. "Dita Ndërkombëtare e Rinisë"
9. "Dita ndërkombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz"
10. "Dita Ndërkombëtare për Parandalim të Dhunës ndaj Fëmijëve"
11. "Dita Ndërkombëtare kundër HIV/AIDS"
12. Kros vjeshtor
13. Festat e fundvitit.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, GJEODEZI KADASTËR DHE PRONË

Gjatë vitit 2017, DPUGJKP-ja i ka kryer punët dhe detyrat e punës të cilat bien në fushën e saj të përgjegjësisë.

Sektori i Urbanizmit i ka lëshuar gjithësejt- 35 aktvendime për kushtet ndërtimore, 32 Leje Ndërtimore, 3 Leje Ndërtimore pa pagesë- Xhamia në fshatin Babimoc, aneksi i QKMF-së në Obiliq dhe aneksi shkollës në fshatin Plemetin.

Të hyrat nga ky sektor gjatë këtij gjashtëmujori janë gjithësejt: 52,648.98€.

Sektori i Gjeodezisë, Pronës dhe Kadastrit i ka kryer:

1. Kontrata të shitëblerjes- 272
2. Kontrata mbi ndarjen e paluajtshmërisë- 49
3. Aktvendime të trashigimisë- 82
4. Regjistrim i hipotekës- 49
5. Fshirje e hipotekës- 33
6. Kontrata të faljes (dhurimi)- 96
7. Parcelizim- 93
8. Bashkim dhe ndarje- 14
9. Kthim i kufijve- 6
10. Regjistrim i barrës tatimore- 0
11. Regjister i kordinatave- 44
12. Regjistrim i parcelave- 21
15. Modifikimi për Personin- 09
16. Vendim Gjyqësor- 05
17. Kontrata të Shitblerjes Qiramarrje për 99 vite- 04
18. Kontrata të Këmbimit- 04
19. Parcelizim dhe rregullim i Kufirit- 02
20. Vendime të Shpronësimit- 09
21. Masa e sigurisë nga Gjykata- 05
22. Historiati i Pronës- 07
23. Regjistrim i Objektit- 04
24. Urdhër nga Përmbaruesi- 03

25. Kontratë e Qiramarrjes së Objektivit të Banimit- 01
26. Aktvendim Administrativ- 01
27. Azhurim i Parcelave- 01
28. Regjistrim i Servitutit- 08
29. Ndarje e Kushtëzuar- 01
30. Ndarje Faktike- 01

Të hyrat janar- dhjetor janë: 40,608€.

Çertifikata të pronës së paluajtshme 2485, kopje e planit 1066 dhe çertifikata të gjendjes pronësore 1603, me të hyra prej 16,205€.
Këto janë pak a shumë punët të cilat i kanë kryer sektorët e DPUGJKP-së.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Drejtorja e Inspektoratit, duke u bazuar në kompetencat e saj, të cilat janë të rregulluara me Statutin e Komunës, Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, Rregullores Komonale; për këtë vit kemi kryer punët e përditshme që e karakterizojnë drejtorinë tonë. Prioritet për këtë vit, kemi pasur kontrollin dhe mbikëqyrjen e punës e subjekteve afariste, kontrollimin e produkteve ushqimore, kontrollin higjienik-sanitar të objekteve që zhvillojnë veprimtari tregtare, hoteliere, zejtare, institucionet edukativo-arsimore, institucioneve shëndetësore.

Arritjet dhe rezultatet e punës sonë, janë të përmbledhura dhe paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Kurse në mënyrë të detajuar, rezultatet janë të paraqitura veç e veç në raportet e Inspektorëve të lëmive përkatëse.

Raporti i punës një vjeçare Drejtorisë së Inspektoratit; janar-dhjetor 2017	Gjithsej
Numri i Inspektimeve të Përgjithshme me Procesverbal	487
Numri i Kërkesave nga Palët	91
Numri i Ftesave për Palët	21
Inspektime të Përbashkëta me Policinë	18
Fletëparaqitje për Gjykatë	5
Inspektime me Inspektor Shtetëror	13
Gjobë Mandatorë	15

- Inspektori i Ndërtimit,

Në mënyrë të detajuar, puna e Inspektorit të Ndërtimit, është paraqitur edhe në formë tabelore.

Nr.	Raporti 6 mujor i punës së Inspektorit të ndërtimit; janar-dhjetor 2017	Gjithsej	Emri i subjektit
1	Numri i inspektimeve të objekteve me leje ndërtimi	37	
2	Numri i inspektimeve të objekteve pa leje ndërtimi	24	
3	Numri i Rrethimit të objekteve	2	
4	Numri i inspektimeve të objekteve me kushte ndërt.	4	
5	Numri i kërkesave nga palët	18	
6	Inspektimet me procesverbal	69	
7	Inspektimi i përbashkët me inspektor	223	
8	Inspektimi i përbashkët me inspektorët e MMPH-së	4	
9	Inspektimi i përbashkët me policinë e Kosovës	5	
10	Inspektime jashtë sektorit të ndërtimit	3	
11	Fletëparaqitje për Gjykatë	1	
12	Gjoha mandatorë	1	
13	Aktvendime	3	Për rrënim:
14	Vërejtje	14	
15	Puna në komision për pranime teknike dhe kushte sanitare-teknike	47	
16	Ftesa për palë	26	

KONKLUZION

Bazuar në gjendjen aktuale në Territorin e Komunës së Obiliqit konkretisht ndarjen e zonave me dedikim të veçantë të shfrytëzimit të tokave dhe mundësitë e qytetarëve për nevoja në ndërtim, konsiderojmë se është e nevojshme një qasje direkte rreth një zgjidhjeje në këtë sektor.

Mendoj që gjendjen e ka vështirësuar edhe dështimi i Ligjit Nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, ku sipas disa statistikave ka dështuar tërësisht si proces, dhe pritjet e një Draft-Ligji tjetër për legalizim të objekteve ndërtimore.

Potencialisht edhe gjatë kësaj periudhe kohore nga dt. 01.01.2017 e deri më 29.12.2017 kemi kryer inspektime rreth ndërtimeve të objekteve të ndryshme dhe në fokus kemi pasur mënyrën rreth vetëdijesimit të qytetarëve rreth procedurave për tu pajisur me leje ndërtimore në mënyrë që të evitohen parregullsitë në aspektin Urbanistik .

Po ashtu kemi marrë masa në disa raste ku kemi hasur në persona të pa ndërgjegjshëm në aspektin e mospërfilljes së urdhërësive që i parasheh Ligji i Ndërtimit Nr. 04/L-110, si dhe UA, Nr. 05/2017 nga ky ligj në fuqi.

Andaj në bazë të përkushtimit në këtë drejtim dhe performancës, mund të konkludojmë se kemi arritur rezultate, pavarësisht rezultateve dhe pritjeve të dëshiruara për tu arritur objektivat e punës tonë.

- Inspektori i Komunikacionit,

Në mënyrë të detajuar, puna e Inspektorit të Komunikacionit, është paraqitur edhe në formë tabelare.

Nr.	Raporti i punës së Inspektorit të komunikacionit; janar-dhjetor 2017	Gjithsej:	Emri i subjektit
1	Numri i inspektimeve	95	
2	Numri i inspektimeve ne transportin e udhëtarëve	20	
3	Numri i inspektimeve ne transportin e mallrave	15	
4	Numri i inspektimeve te ndryshme, brezi rrugës, akset e rrugëve etj.	60	
5	Numri i kërkesave nga palët	20	
6	Kërkesë për policinë ne asistence	4	
7	Inspektimi i përbashkët me inspektor	413	
8	Inspektimi i përbashkët me inspektorët e MI-së	6	
9	Inspektimi i përbashkët me policinë e Kosovës	4	
10	Fletëparaqitje për Gjykatë	3	
11	Vërejtje gojore	40	
12	Ftesa për palë	13	

- Inspektori I Tregut,

Në mënyrë të detajuar, puna e Inspektorit të Tregut, është paraqitur edhe në formë tabelare.

Nr.	Raporti i punës së Inspektorit të tregut; janar –dhjetor 2017	Gjithsej	Emri i Palës
1	Numri i Inspektimeve te përgjithshme	421	
2	Inspektime me procesverbal	112	
3	Numri i Inspektimeve të lokaleve shërbyese dhe tregtare	44	
4	Numri i Inspektimeve të lokaleve hoteliere	40	
5	Numri i Inspektimeve pompave te benzinës	3	
6	Numri i Inspektimeve të Barnatoreve	6	
7	Numri i Inspektimeve të N. Ndërtimore	/	

8	Inspektimi i përbashkët me Inspektoret shtetëror	3	
9	Inspektimi i përbashkët me Policinë e Kosovës	4	
10	Fletëparaqitje për Gjykatë	/	
11	Gjoha mandatorë	2	
12	Numri i kërkesave nga palët	47	
13	Pranime me komision	47	
14	Inspektime në shoqërim me inspektorët të tjerë	236	
15	Numri i inspektimeve të Ordinancave	7	
16	Inspektime në Sallone Ondulimi	4	
17	Inspektim në përpunimin e produkteve	10	
18	Asgjësim të mallit	1	
19	Ftesa për palë	4	

Gjatë kësaj periudhe kohore të inspektimit si prioritet kemi pasur kontrollin e produkteve ushqimore gjegjësisht afatet e tyre, deklaracionin e mallit, Masat e marra sa i përket produkteve ushqimore gjatë kësaj periudhe kemi pasur 85. Raste të asgjësimit të mallit me kërkesë nga pala 1(40,00€) Gjoha mandatorë 2 (250,00 €) dhe 5. Lokale të mbyllura, 47 pranime teknike vlera në euro 2.115,00€.

Me këto masa të marra kemi arrit që ti vetëdijësojmë bizneset në ushtrimin e veprimtarive afariste konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, Këtë më së miri e vërteton fakti që është zvogëluar numri i ankesave nga qytetarët dhe regjistrimin e 47 subjekteve të reja.

- Inspektori Sanitar

Në mënyrë të detajuar, puna e Inspektorit Sanitar, është paraqitur edhe në formë tabelare.

Nr.	Raporti i punës së Inspektorit sanitar; janar –dhjetor 2017	Gjithsej	Emri i Palës
1	Inspektime të përgjithshme	478	
2	Inspektime me procesverbal	211	
3	Inspektime në lokale ushqimore	82	
4	Inspektime në lokale hoteliere	69	
5	Inspektime në barnatore	12	
6	Thirrje për palë	4	

7	Gjoha mandatorë	12	
8	Të proceduara për Gjykatë	1	
9	Fabrika për prodhimin e produkteve	3	
10	Numri i kërkesave nga palët	6	
11	Inspektime në furra	11	
12	Inspektime në Sallone Ondulimi	12	
13	Inspektime në Pishina	4	
14	Asgjësim të mallit një me kërkesë	13	
15	Inspektime Komunale	8	
16	Inspektim në Ordinancat Stomatologjike	2	
17	Eskumim - Zhvarrim të kufomave	1	
18	Inspektim në lojëra - konter - fliper	1	
19	Inspektime me Policin	5	
20	Inspektime- Pranime me komision	47	
21	Inspektim në shoqërim me Inspektorët tjerë	216	

INSPEKTORATI SANITAR - Sipas planit të punës Inspektori Sanitar, gjatë këtij viti prioritet kemi pasur kontrollin e kualitetit të ushqimit, kushteve higjienike-sanitare të objekteve që zhvillojnë veprimtari tregtare, hoteliere, zeytare, pastaj objekteve për mirëmbajtje të higjienës personale, objekteve publike. Në mënyrë permanente është bërë inspektimi i artikujve ushqimor me pakicë dhe shumicë si në objekte ashtu edhe jashtë tyre, kontrolli i kushteve higjienike-sanitare, asgjësimin e mallit kur është në pyetje afati i përdorimit, ndalimi i ekspozimit të artikujve ushqimor për shkak të faktorëve të jashtëm natyrorë, kontrollin për librezë sanitare, kontrollin për konsumimin e duhanit në vende publike.

Masat e ndërmarra gjatë kësaj periudhe; kemi pasur 15 raste të asgjësimit të mallit, 12 gjoha mandatore, si dhe vërejtje të dhëna me gojë dhe me shkrim aty ku e kemi pa të nevojshme. Me këto masa të marra kemi arritur që t'i vetëdijësojmë bizneset në një mas të madhe. Këtë mësim të vërtetë fakti që është zvogëluar numri i ankesave nga qytetarët.

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Gjatë vitit 2017 jemi përgjigjur dhjetra kërkesave të qytetarëve, shkresa për institucione të ndryshme, projekttime dhe menaxhime të kontratave si për DIL ashtu edhe për Drejtoritë tjera kërkuese Komunale dhe projekttime për donatorë (si qeveritar dhe jo qeveritar). Buxheti i drejtorisë për investime për vitin 2017 ka qenë 892,892.00 euro.

I ndarë në shtylla:

Hartim i projekteve	30,000.00
Asfaltim dhe trotuare	552,892.00
Kanalizime	100,000.00
Ekspropriim	10,000.00 dhe
Bashkëfinancim	200,000.00

Projekte të vitit 2016-2017:

1. Ura ne Plemetin, 80 m gjatësi (bashkëfinancim)
- Projektet e vitit 2017 simbas emërimit, të proceduara në prokurim :
 1. Ndryçimi publik Obiliq-Mazgit (financuar nga KEK)
 2. Shtëpi për të pame në Lajthishtë (bashkëfinancim)
 3. Rrugë në Babimoc, te California (bashkëfinancim)
 4. Rrugë me asfalt (pjesa e parë): Rr. "Dëshmorët", Rr. "Muhaxhiri", Rr. "Koliqi", Rr. "Troja" dhe Rr. "Ajete Kelmendi"
 5. Rrugë me kubëza (pjesa e dytë): Rr. "Fortesa", "Lagjia Jashari" që lidhet me Rr. "Halit Bici", Rr. "Abaz Pllana" dhe Rr. "Janina"
 6. Kanalizim fekal në Obiliq me rrethinë (pjesa e parë)
 7. Kanalizim fekal dhe atmosferik në Plemetin (bashkëfinancim me IOM)
 8. Rrugë dhe kanalizim fekal në Babimoc: Rr. "Car Dushan", Rr. "Fortesa" dhe Rr. "Dituria" (bashkëfinancim me MAPL)
 9. Rrugë me asfalt (pjesa e tretë): Rr. "Shemsi Hoti", ;Rr. "Azem Hajdari", Rr. "Hakif Berisha", 'Lagjia Mehmeti' në Plemetin, 'Faruk Begolli', 'Mati' dhe 'Sadik Hamiti'
 10. Pastrimi i lumit Sitnica (i financuar nga MMPH, projektin detal Komuna)
 11. Hartim i projekteve për drejtoritë kërkuese
 12. Testim i ngjeshmërisë së zhavorit nëpër rrugë
 13. Rruga te "Euro Panel"
 14. Rregullimi i urës në Raskovë
 15. Kanalizim fekal në Obiliq me rrethinë (pjesa e dytë)
 16. Rrugë me asfalt (pjesa e katërt): Rr. "Lugina e Matit", ;Rr. "14 Qershori" dhe te "QPS"
 17. Trotuare: Rr. "Shaban Polluzha", Rr. "Pjetër Bogdani", Rr. "1 Tetori" dhe Rr. "Mbretëresha Teutë"
 18. Rrugë me asfalt (pjesa e pestë): Rr. "Rilindja" dhe Rr. "Ali Podrimja"
 19. Ndryçim publik, nga qendra deri tek Kosova B (i financuar nga KEK)

Projektet e vitit 2017 të përmbledhura për metër gjatësi

1	Rrugë me asfalt	6307 m
2	Rrugë me kubëza	1336 m
3	Ndryçim publik	6850 m
4	Trotuare	2108 m
5	Sistem i ujërave të zeza	11717 m
6	Sistem i ujërave atmosferik	336 m
7	Pastrim i lumenjëve dhe prockave	18147 m

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të mbrojtjes së mjedisit. Aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të Drejtorisë:
Monitorimi ditor i shërbimeve mjedisore :

- Monitorimin e gjendjes mjedisore- ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A dhe TC- B, Divizionit të Qymyrit dhe raportit të Institutit Hidrometeorologjik,
- Pastrimi dhe larja e trotuareve dhe rrugëve,
- Mirëmbajtja e shesheve dhe parqeve,
- Aktivitete ditore në vendbanimet që janë të përfshirë në bartje dhe grumbullim të mbeturinave komunale.

Aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:
Monitorimi ditor i shërbimeve mjedisore dhe ofrimi i shërbimeve mjedisore komunale:.

- Pastrimi dhe larja e rrugëve dhe trotuareve,
- Mirëmbajtja e shesheve dhe parqeve ,
- 83% të vendbanimeve janë të përfshirë në bartje dhe grumbullim të mbeturinave komunale.

Projektet mjedisore që janë zbatuar këtë vit:

- Mbjellja e drunjëve urban,
- Pastrimi i deponive ilegale,
- Rregullimi dhe thurja e varrezave,
- Furnizimi me kontenjer,
- Rrethoja e parkut nënë hekurudhë.

Mbjellja pranverore dhe vjeshtore e drunjëve urban në komunën e Obiliqit

- Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit edhe këtë vit sikur edhe vitet e kaluar është përkujdesur jo vetëm në ruajtjen e ambientit në Komunën tonë, por edhe në rritjen e sipërfaqeve të gjelbëruar duke bjellur 1200 drunjë dekorativ në territorin e Obiliqit.

Është bërë furnizimi me 50 kontejner për mbeturina me vëllim prej 120L, të cilët janë shpërndarë në fshatin Graboc .

DMM ka filluar të punoj edhe në hartimin e palnit për menaxhimin e mbeturinave për futjen në sistem të të gjitha ekonomive familjare

Rregullimi i varrezave dhe mirëmbajtja e tyre

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit edhe këtë vit është përkujdesur për rregullimin e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre, projekt i cili përfshinë varrezat në fshatërat Kozaricë, Mazgit, Shipitullë 'Lagja e Krasniqve', dhe Babimost.

Rregullimi i varrezave do të vazhdoj edhe në fshatrat tjera me qëllim të ofrimit të çasjes më të lehtë për shërbime mortore dhe përkujtimore.

DEZINSEKTIMI

Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit ka implementuar projektin : **Dezinesktimi Hapësinor në Obiliq** (eliminimin e insekteve, mushkonjave). Ky proces është realizuar në tri faza, Dezinspektimi është një metodë që merret me zhdukjen e bartësve të shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare, nënkupton zhdukjen me preparate të caktuara të cilat janë me selektivitet të lartë pasi që insektet fluturuse gjenden në rrethin ku ne jetojmë. Preparati i përdorur në të dy fazat është preparati 'Aqua Kontrol', preparati në fjalë është i lejura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) për përdorim në hapsira publike, është i padëmshëm për njerëz, kafshë dhe bimë.

• Rrethoja e parkut nën hekurudhë

DMM në bashkëpunim me KEK-un kanë realizuar projektin e ndërtimit të 'Parkut të Qyrtetit' nën hekurudhë i financuar nga KEK-u.

DMM duke parë të nevojshme ka bërë thirrjen e parkut me të hyra nga buxheti komunal.

Bashkëpunimi me organizata që veprojnë në Kosovë

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, kishte hyrë në ngarë për mjedis të pastër të organizuar nga Gizi – Gjerman., DMM kishte formuar ekipin i cili kishte punur në përmbushjen e kriterëve të parapara. Komuna është përfutuse e 66 mijë eurove ku jemi radhitur si komuna e 4 – të në mesin e 16 komunave pjesëmarrëse.

Në kuadër të mbikëqyrjes së aktiviteteve, përputhshmërinë e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore për mbrojtje të mjedisit, është bërë kontrollë në Deponinë Regjionale në Mirash. Në bazë të inspektimeve që kanë bërë zyrtarët komunal të mjedisit në Deponinë Rajonale në Mirash.

SH.A.(KLMC - në kanë konstatuar se nuk është në pajtim me kriteret dhe kushtet të cilat janë përcaktuar me planin operativ të bazuar në nenet 20, 21 dhe 22 të Ligjit Nr.02/L-30 , dhe janë dhënë këto kriter që duhet ti përmbushë:

1. Përgatitjen e lokacionit me pajisjet për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes (sistemin për drenazhimin e ujërave të ndotura, sistemin për zënien dhe trajtimin e ujërave të ndotura, sistemin për administrimin e gazrave të deponisë, sistemin e administrimit të ujërave sipërfaqësor, sistemin për realizimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e shtresës përfundimtare për mbulimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e vendit);
2. Infrastrukturën e deponisë për mbeturina (rrethoja, rrjeti i ujit dhe rrymës, rrugët etj);

3. Zhvillimin e punëve në lokacion (kontrollin e mbetjeve të mundshme, mbrojtjen nga zjarri në deponi, pranimin e mbeturinave dhe procedurat për kontroll, marrjen e mostrave dhe analiza e mbeturinave, sistemin për matjen e sasisë së mbeturinave, shkarkimin, shtrirjen dhe ngjeshjen e mbeturinave, mbulimin e përditshëm të mbeturinave, sipas nevojës);
4. Mbikëqyrjen e vazhdueshme, kontrollimin e ndotjes dhe njoftimin (kontrollimin e gazrave dhe gazrave specifike të deponisë, njoftimin për përbërjen e mbeturinave, kontrollimin dhe njoftimin për ujërat e ndotura dhe inçizimin e kushteve meteorologjike);
5. Administrimin dhe mbikëqyrjen e kushteve në deponi (kontrollimi, monitorimi dhe lajmërimi për pluhurin dhe thërmirat e suspenduara, kundërmimet, zhurmën, kafshët dhe shpezët që gravitojnë në deponi, kontrollimin e shkarkimit, shtresimit, kompaktimit dhe mbulimit të mbeturinave);

Inspektimi i transporteve që bartin mbeturina

Në kuadër të kompetencave të Ligjit për Mbeturina dhe planit për kontrollë dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar kontroll të vazhdueshëm të kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë Regjionale Sanitare në Mirash. Inspektimi është bërë me inspektorët komunal dhe është asistuar nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Stacioni Policor në Obiliq. Aktiviteti i inspektimit u përqëndrua në rrugën Dardhishtë- Mirash. Gjatë kësaj periudhe u ndaluan të gjitha automjete transportuese që bartin mbeturina komunale. Në vendin e ngjarjes iu dhanë vërrejtjet dhe rekomandimet e duhura në përputhje me Ligjin për Mbeturina dhe ju shqiptuan edhe gjoba .

Drejtorja për Mbrojtjen e Mjedisit, për nder të 22 Prillit, Ditës Botërore të Planetit Tokë

- Drejtoria Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit si bartëse e aktiviteteve e shoqëruar nga Organizata Rinore, OJQ , Policia e Kosovës dhe nxënës të shkollave të mesme organizuan një sërë aktivitete duke filluar nga orët e mëngjesit për të shënuar edhe simbolikisht ‘Ditën e Tokës’.
- Kryesisht u mbollën lule sezonale dhe drunjë dekorativ.
- 24 Maj në aksionin “Ta pastrojmë Kosovën” u përfshinë Komuna, shoqëria civile, nxënësit e të gjitha niveleve, kompanitë publike për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe FSK-ja. Të gjitha këto subjekte iu përgjigjën pastrimit të ambienteve të ndryshme në të cilat janë hedhur mbeturinat duke filluar nga mjediset ku punojnë e veprojnë si; shkolla, rrugë, parqe etj.
- Drejtoria Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit si bartëse e aktiviteteve, së bashku me shoqërinë civile, nxënës të të gjitha niveleve pastruan lokalitetet e veta në qytet e vende të tjera. Në ndihmë u doli edhe kompania “Pastrimi”.

Pastrimi i deponive ilegale

- Në bashkpunim me KEK-un ka vazhduar largimi i deponive ilegale nga keto lokacione: Plemtin, te ‘Lagja Aliaj’, Milloshevë, Raskovë, Babimost etj.

- Në kuadër të garës për mjedis të pastër janë evidentuar 55 deponi ilegale. Komuna ka bërë eliminimi (pastrimi) e 45 deponive të tilla, me çka ka dalur edhe përfituese e grantit.
- Gjatë kësaj periudhe kohore, janë dhënë 11 leje mjedisore komunale, nga zyrtari mjedisor, janë kryer gjithsej 80 kontrollime të ndryshme rutinore e të planifikuar, janë dhënë 30 vërejtje verbale dhe 51 inspektive jo-rutinore sipas kërkesave të qytetarëve.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCAVE

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Vizioni:

Ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Komunës në baza ditore, javore dhe mujore.

Prioritet për vitin 2017

1. Ofrimi i shërbimeve komunale dhe regjionale sa më cilësore për qytetarët e komunës.
2. Përmirësimi dhe sanimi i ndriçimit Publike në qytet dhe lagje .
3. Trajtimi i ujërave të zeza fekale dhe atmosferike nëpër fshatra.
4. Trajtimi i ujërave të zeza-urbane
5. Trajtimi i hapësirave publike në qytet dhe fshatra
6. Ofrimi i shërbimeve publike sa më cilësore
7. Investime publike në rrejte të energjisë dhe ujësjellës .

Aktivitetet për vitin 2017

- Mirëmbajtja e rrugëve dhe pastrimi i tyre gjatë dimrit
- Menaxhimi i situatave emergjente- Mars 2017 (Ushtrimi Fushor: DSHPE-FSK)
- Shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV
- Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik në territorin e komunës së Obiliqit (dy faza)
- Renovimi stacioneve (vend ndalje) në qytet
- Mirëmbajtja e rrugëve me asfalt (trajtimi i gropave)
- Mirëmbajtja dhe debllokomi i kanalizimeve
- Plani komunal për trajtim të hapësirave publike (nëse arrimë përkrahje nga DEMOS)

Prioriteti 1

- a) Sezoni dimëror 2016/2017 , mirëmbajtja e rrugëve gjatë stinës së dimrit,

b) *Projekti sanimi i rrugëve me asfalt*
Këto vite kemi planifikuar që të sanohen rrugët lokale edhe ato lidhëse të fshatrave ku janë dëmtuar në masë të madhe nga lëvizja e madhe e makinerisë së rëndë dhe dëmtimi i tyre, si dhe vendosja e pengesave në rrugë me kërkesë të banorëve dhe lagjeve.
Projekti është në fazën përfundimtare të nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik .

Prioriteti 2

a) Ka përfunduar projekti i ndërtimit dhe renovimi i vende ndaljes së autobusëve në qytet,

Prioriteti 3- Menaxhimi i situatave emergjent- Mars 2017 (Ushtrimi Fushor: DSHPE-FSK)

b) Në bazë të plani vjetor të punës për vitin 2017 dhe Planit Komunal për Efëçencë të Energjisë 2014-2020, kemi filluar me renovim/shtrirje të rrjetit në disa lagje në qytet (lagjet nën hekurudhë) po ashtu në disa lagje të tjera në fshatra me ndriçim publik efeçient .

Prioriteti 3 Shtrimi dhe mirëmbajta e rrugëve të rendit të IV

Jemi në realizim të trajtimit të rrugëve në lagje e fshatëra, duke filluar nga fshati Mazgit, Milloshevë, Lajthishtë, Bakshi, Raskovë , këto ditë fillojmë trajtimin e rrugëve në fshatra e lagje: Shipitullë, Graboc , Siboc, Hamidi, Dardhishtë, Obiliq i Vjetër, Kozaricë, Breznicë, Hade.

Prioriteti 4 Do të vazhdojmë edhe me pjesë të tjera të rrugëve në fshatin Milloshevë, Raskovë e Bakshi me ndriçim publik, arsyeja pse janë duke rinovuar rrjeti i energjisë elektrike me trupa të betonit dhe kabull bistek nga ana e KEDS-it. Deri me tani është shfrytëzuar rrjeti i furnizimit me energji edhe rrjet të ndriçimit publik e që është një lehtësim i madhe për ne si Komunë.

Prioriteti- 3 Trajtimi i ujërave të zeza fekale dhe atmosferike nëpër fshatra.
Janë trajtuar e rinovuar rrjetet e ujërave të zeza e të bardha: Obiliq te familja Hashani (rasti i trajtuar në Kuvendit Komunal), Mazgit te lagjja Morina. Shkabaj janë eliminuar dy grupa

skeptike të lagjeve: “Jashari”, “Gashi” dhe “Makolli”, Dardhishtë te lagja “Gashi”, Llazarevë te lagja “Ismalji” po ashtu edhe trajtimi i kanalit kullues në këtë lagje .

Prioriteti- 4. Trajtimi i ujërave të zeza-urbane

Janë mirëmbajtur në vazhdimësi ujërat urbane atmosferike., Në këtë sferë, kemi pasur një bashkëpunim të mirë edhe me KUR-Prishtinën.

Prioriteti- 5 Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik në territorin e komunës së Obiliqit (dy faza) Ka filluar faza e parë e projektit në qytet e fshatra sipas emërimit të rrugëve. Milloshevë, Siboc, Obiliqi, Mazgit i Poshtëm, Mazgit i Epërm, Lathishtë, Shipitullë, Hade, në të gjitha këto lagje.

Më poshtë gjeni edhe në formë tabelare .

Rekapitulim - Ndriçimi Publik i rrugëve në fshatin Milloshevë	
Emertimi	Gjatësi
1 Rrugët: Pëllazkët dhe Azem Shkreli	478 m
2 Rruga: Raif Krasniqi	1185 m
3 Rruga: “Qyqavica”	206 m
4 Rruga: “Oso Kuka”	406 m
5 Rruga: “Balshaj”	578 m
6 Rr: “Gurbardhi”	783 m
7 Rr: “Muzakaj”	440 m
8 Rr: “Muhaxheri”	481 m
9 Rr: “Sogujeva dhe Kuvendi i Lezhës	1006 m
10 Rr: “Ahmet Shipoli”	258 m
11 Rr: “Molla e Kuqe dhe Bllaca”	258 m
12 Rr: “Nëntori i Dytë”	200 m
13 Rr: “Ujëvarat dhë Përveticat”	240 m
14 Rr: “Hoxhë Ali Çerkezi”	323 m
15 Rr: “Kurshumlia”	200 m

16	Rr: "Ibrahim Kodra"	245 m
----	---------------------	-------

Rekapitulim - Ndriçimi publik i rrugëve në fshatrat: Mazgi, Plemetin dhe Dardhishtë		
1	Mazgit-Rrugët : "Mbreti Bardhyl "dhe "Dyzi" "	520 m
2	Mazgit-Rrugët : "Opoja "dhe "Ali Podrimja " dhe "Pishat"	1054 m
3	Mazgit -Rr: "Halil Bici"	1200 m
4	Mazgit-Rr: "Fortesa"	200 m
5	Mazgit-Rruga: "Mavriqi"	880 m
6	Plemetin -Rr: "Bregaj dhe Xhema "	1750 m
7	Plemetin -Rr: " Hakif Thaqi"	660 m
8	Plemetin -Rr: "Isuf Pllana"	270 m
9	Plemetin-Rr: "Faruk Ibrahimimi"	300 m
10	Dardhishtë-Rr: "Ali Maloku"	970 m
11	Dardhishtë-Rr : " Nuhi Kelemendi & Mirdita" ""Mirdita "	1420 m

Rikapitulim - "Ndriçimi Publik i rrugëve në fshatrat :Mazgi,Shkabaj dhe Obiliq		
1	Mazgit -Rr:Dita e Flamurit	1,840 m
2	Mazgit-Rrugët : " Ledina ", "Qendresa " "Gollaku " dhe " rruga e Xhamise	1,275m
3	Mazgit -Rr: "Kozmaqi"	285 m
4	Mazgit-Rr: "Agron Rrahmani "	485 m
5	Shkabaj në rrugën:"Azem Hajdari", "	540 m
6	Shkabaj në rrugën:"Qajupi "	395 m
7	Obiliq -" 14 Qershori, Lugina e Matit,Anton	750 m

Cetta dhe Jahja Hashani "	
Total	

Rikapitulim - Ndriçimi Publik i rrugëve në Obiliq		
1	Obiliq -Rr: "Abaz Pllana "	400 m
2	Obiliq -Rr: "Shkupi"	530 m
3	Obiliq-Rr: "Lumjanët"	460 m
4	Obiliq-Rr: "Martirët Grajqevci"	175 m
5	Obiliq-Rr: "Fejzullah Grajqevci"	1150 m
6	Obiliq -Rr: "Teuta Mbretreshë"	515 m
7	Obiliq-Rr: "Hamëz Jashari"	350 m
8	Obiliq -Rr: "Butriniti"	320 m
9	Obiliq -Rr: "Fahri Fazliu"	280 m

Rekapitulim -Ndriçimi Publik i rrugëve në fshatrat: Siboc, Lajthishtë, Shipitullë dhe Hade		
Emërtimet		Gjatësia
1	Rrugët : "Agron Gashi" dhe Oborri i shkollës	
2	Rruga : "Toplica"	
3	Rruga: "Vlera"	
4	Rruga: "Hamit Thaqi"	
5	Rruga : "Lluga e Kovaqit"	
6	Rr: "Shemsi Hoti"	
7	Rr: "Mulla Hamza"	
8	Rr: "Musli Krasniqi"	
9	Rr: "Kelmendi", "Guri i Sibocit" dhe "Ajet Kelmendi"	
10	Rr: "Sefedin Hoti" dhe "Hoti"	
11	Rr: "Izet Likovci"	

12	Rr: "Gjashtë Vëllëzerit" dhe "Musli Gashi"	
13	Rr: "Mehmet Rexha"	
14	Shipitullë	
15	Lajthishtë	
16	Hade-Minatori	

Rekapitulim - Ndriçimi publik i rrugëve territorin e Obiliqit		
1	Siboc, "Lagjja Mexhuani"	1900 m
2	Mazgit, Rr: "Bahri Fazliu"	220
3	Bakshki-Rr: "Zahir Pajazit"(pjesa e pa perfunduar)	170
	Total	

Raporti mbi shpenzimet e naftës /benzinës për administratë dhe arsim

Shpenzimet e naftës dhe benzinës për veturat dhe minibusët e Komunës për vitin 2017							
Veturat			Veturat		Minibusët		Vetura ,Minibusa
Benzinë			Naftë		Naftë		Benzinë ,naftë
Nr	Muaji	Vlera në euro	Muaji	Vlera në euro	Muaji	Vlera në euro	Vlera mujore
1	Janar	160.92	Janar	1,128.61	Janar	489.07	1,778.60
2	Shkurt	177.05	Shkurt	813.72	Shkurt	646.94	1,637.71
3	Mars	326.39	Mars	1,195.86	Mars	781.64	2,303.89
4	Prill	137.80	Prill	1,113.21	Prill	717.08	1,968.09
5	Maj	446.33	Maj	1,090.69	Maj	1,113.59	2,650.61
6	Qershor	364.45	Qershor	1,161.08	Qershor	610.03	2,135.56
7	Korrik	275.06	Korrik	1,058.56	Korrik	113.34	1,446.96
8	Gusht	274.87	Gusht	1,328.22	Gusht	266.4	1,869.49
9	Shtator	334.81	Shtator	1,220.58	Shtator	822.42	2,377.81
10	Tetor	435.41	Tetor	820.50	Tetor	899.88	2,155.79
11	Nëntor	342.81	Nëntor	1,089.39	Nëntor	877.94	2,310.14
12	Dhjetor	326.57	Dhjetor	868.91	Dhjetor	753.82	1,949.30
13	Gjithsejt	3,602.47	Gjithsejt	12,889.33	Gjithsejt	8092.15	24,583.95
Totali i shpenzimeve të derivateve është: 24,583.95							

SHPENZIMET E ADMINISTRATËS KOMUNALE DHE ARSIM & KULTURËS 2017

Nafte/Benzinë– 24,583.95

Ngrohja -5000

Total -29,583.95 euro .

Nafte/Benzinë– 27,837.70 -2016

Ngrohja -5000

Total -32,837.70 euro

Aktivitetet e tjera të DSHPE-së

Pas shumë takimeve e presioni KEDS, ka pranuar që në planin investiv, të investoj në këto lokacione në rrjete dhe trafo:

1. Darshishtë
 2. Obiliq
 3. Sibofc (lagja Mexhuani dhe Kongjrli) e përfunduar
- Kemi dorëzuar edhe kërkesën e ndërrimit nga trafo kulla në trafo Blind për këto lokacione :
1. Obiliq (Rr.Hasan Prishtina ,lagja Ratkoceri)
 2. Llazarevë (përball stadiumit të fshatit)
 3. Breznicë dhe Kozaricë, rrjet i ri dhe trafo (kanë filluar punimet)
 4. Obiliq i vjetër

Këtë vit planifikojmë të investojmë/renovojmë në rrjet të ujësjellësit së bashku me KUR-Prishtina në qytet dhe disa fshatra: Lajthishtë, Babaimost, Obiliqi i vjetër dhe lagja të elektrobarja.

Këtë vit janë vendosur dy pompa të ujit, në Palaj dhe Siboc kështu që është përmissuar dukëshëm furnizimi me ujë për këtë lokalitet, gjithashtu fshati Babimoc do të furnizohet për herë të parë me ujë të pishshëm që nga pas lufta .

Në kuadër të drejtorisë janë përgatit edhe plane ideore për donatorë të jashtëm (paramasat dhe parallogaritë nga DPUK dhe DSHPE).

1. Projekt/propozim për USAID/CDF –Strategjia e Komunës 2017-2021- e aprovuar faza finale,
2. Propozim projekt për KEK-un , ndriçimi publik, nga Instituti i Mjekësisë së Punës deri tek hyrja për Dardhishtë, është në proces
3. Lista e projekteve për MAPL- për vitin 2017 (Babimoc), projekt i finalizuar .
4. Lista e projekteve për MAPL- për vitin 2017 (lagja Fana, Rexhepi) projekti në proces .
5. Lista e projekteve për Ministrinë e Infrastrukturës (Trotuar dhe ndriçim publik: Obiliq – Milloshevë –Bakshi dhe Projekti i ndriçimit: (Milloshevë-Mazgit-Shkabaj)

Rastet e zjarrit për vitin 2017

Rastet e zjarreve gjatë vitit 2017				
Nr	Vendi	Data	Pronësia	Dëmet
1.	Dardhishtë	05.01.017	Private	Djegje shtëpisë
2.	Plemetin	18.03.017	Private	Djegje e veturës
3.	Millosevë	05.07.017	Private	Djegje e grurit në ara
4.	Graboc	02.08.017	Private	Djegje e pyjeve
5.	Llazarevë	07.08.017	Private	Djegje e shtëpisë
6.	Graboc	07.08.017	Private	Djegje e pemishtes
7.	Millosevë	08.08.017	Private	Djegje e barishtave
8.	Shkabaj	10.08.017	Private	Djege e veturës
9.	Lajthishtë	19.08.017	Private	Djegje e hambarit për grurë
10.	Plemetin	28.08.017	Private	Djegje e disa drunjve në shtëpinë ndihmëse
11.	Graboc	03.09.017	Private	Djegja e pemishteve
12.	Obiliq i vjetër	03.09.017	Private	Djegje shtëpisë
13.	Bajmoc	05.09.017	Private	Djegje e veturës
14.	Kozaricë	04.09.017	Private	Djegje e barishtave
15.	Palaj	08.09.017	Private	Djegje e barishtave
16.	Obiliq	13.09.017	Private	Djegje e shtëpisë

Raporti i trajtimit të rrugëve me zhavor.

Në këtë specifikim përfshihet rrafshimi me greder, furnizimi me zhavor, shtrirja dhe ngjeshja.

Nr.	Lokacioni	m ³	Fraksion	Gjerësia	Gjatësia
1	Millosevë, Rruga e re	420 m ³	Ø(0-60)mm	4 m	280m

2	Millosevë – Pellazgët	144 m ³	Ø(0-30)mm	4m	180m
3	Plemetin – Stara Cesma	210m ³	Ø(0-60)mm	4m	300m
4	Plemetin – Sokoli	146m ³	Ø(0-60)mm	4m	244 m
5	Plemetin – Sava	72 m ³	Ø(0-60)mm	4	150 m
6	Plemetin – Markovac	200 m ³	Ø(0-60)mm	4m	750m
7	Plemetin – Hakif Thaqi	130 m ³	Ø(0-60)mm	4 m	358 m
8	Mazgit – Shaban Sollova	154 m ³	Ø(0-60)mm	4	385m
9	Dardhishtë – L.Gërguri	75 m ³	Ø(0-60)mm	4	118 m
10	Dardhishtë - Asllan Raqi	120 m ³	Ø(0-30)mm	4	153m
11	Dardhishte - Rr. Mërlaku	30 m ³ 60 m ³	Ø(0-60)mm Ø(0-30)mm	4	100 m
12	Dardhishtë – Besnik ,Tërnavë	18 m ³ 60 m ³	Ø(0-60)mm Ø(0-30)mm	4	50 m
13	Millosevë – Tregu për bujqësi	111 m ³	Ø(0-30)mm		
14	Obiliq, te familja Rama	15 m ³	Ø(0-30)mm		
15	Shkabaj, Rr. “Ferma”	200 m ³	Ø(0-60)mm	4	290 m
16	Bakshi – Rr. “Shqiponja”	140 m ³	Ø(0-60)mm	4	167m
16	Bakshi, Rr. “Vllazënia”	45 m ³	Ø(0-60)mm	4	65 m
17	Lajthishtë ,Rr: Sejdi Pllana	170 m ³	ø(0-60)mm	4	250m
18	Lajthishtë , Rr: “Sabedin Pllana” (deformimi, prishja ne rrugë)	90 m ³ 54 m ³	ø(0-60)mm		38 m
19	Lajthishtë –Rr. “Dubova”	119m ³	Ø(0-60)mm	4m	201 m
20	Lajthishtë, Rr. ” Kalaja”	145 m ³	Ø(0-60)mm	4m	165 m
21	Lajthishtë; Rr: “Vehbi Dedinca” dhe rr lidhëse	200 m ³ 75 m ³	Ø(0-60)mm Ø(0-60)mm	4m 4	310 m 110 m
22	Lajthishtë, Rr te xhamia			4	110 m
23	Lajthishtë, Rr, “Ajet Dedinca”	90 m ³	Ø(0-60)mm	4m	150 m
24	Lajthishtë, Rr: “Shefqet Prenku”	40m ³	Ø(0-60)mm	4.m	88 m
25	Millosevë, Rr: “Dardania”	287 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	460m

26	Millosevë, Rr: "Martirët Aliu"	240 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	455 m
27	Millosevë, Rr: "Martirët Aliu" (segmenti kah lagjeja Krasniqi)	120 m ³	Ø(0-60)mm	4	152m
28	Millosevë, Rr: "Bardiqi"	150m ³	Ø(0-60)mm	4	200m
29	Obiliq, Rr. "Pajtimi" dhe një rrugë lidhëse	150 m ³	Ø(0-60)mm	4	175m
30	Hade, të Grajqevcët	57 m ³	Ø(0-60)mm		
31	Brezhnicë, Te Syla	48 m ³	Ø(0-60)mm	4	
32	Shkabaj, Rr. "Matjanët"	40m ³	Ø(0-60)mm	4	150 m
33	Obiliq, lagja të Stacioni	60m ³	Ø(0-60)mm	4	150m
34	Siboc, lagjeja Sadiku	34 m ³	Ø(0-60)mm		
35	Dardhishtë, Rr: "Ibrahim Gërguri"	60 m ³	Ø(0-60)m	4	60 m
36	Dardhishtë, Rr. "Gani Shalaku"	200 m ³	Ø(0-60)mm	4m	180 m
37	Dardhishtë, Rr: "Tërnavë"	60m ³	Ø(0-60)mm	4.m	120 m
38	Dardhishtë, Rr. "Dobratiqi"	30 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	100 m
38	Dardhishtë, Rr. "Raqi "	36 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	m
38	Obiliq , lagjen Aliu	20 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	m
38	Kryshevcë –Hazir Merlaku	40 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	60 m
38	Dardhishtë, Rr: "L,Gjigoli"	42 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	60 m
38	Dardhishtë, Rr: "Lagj Dobratiqi"	40 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	80 m
38	Obiliq, Rr: "Hasan Hasani"	362 m ³ 118 m ³	Ø(0-60)mm Ø(0-31.5)mm	5	800 m
38	Obiliq , Rr: "Çlirimi"	68 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	90 m
38	Obiliq , Rr, "Fatmir Aliu"	36 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	80 m
38	Obiliq, Rr. "Ajet Mjeku"	16 m ³	Ø(0-31.5)mm		
38	Mazgit, Lagj. Berbatovci	92 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	173 m.
38	Mazgit, lagj. Bllaca	16 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	60 m
38	Millosevë Rr. "Raif Krasniqi"	32 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	50 m
38	Mazgit, Rr:"15 Prilli"	32 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	40 m
38	Mazgit, Rr, "Çlirimi"	40 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	40 m

38	Mazgit, Rr, " Çlirimi"	32 m ³	Ø(0-31.5)mm	4	m
38	Hamidi, Knjega Milica	288 m ³ 112 m ³	Ø(0-31.5)mm Ø(0-60)mm	4	440 m
	Total	10,760			16,331 m

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2017 në kuadër të përgjegjësisë të veta ka kryer këto punë dhe detyraë

Janë kryer punët e përditëshme tekniko- administrativeë

Janë realizuar takime të rregullta me MSH dhe është bërë kërkesa për një autoambulancë për të cilën QKMF ka nevojë për arsye të rritejs së shërbimeve dhe amortizimit të atyre që i kemi në shfrytëzim.

Takim me Sekretarin e Ministrisë së shëndetësisë për furnizim me autoambullacëë

Kontakte me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare që merren me çështjet shëndetësore dhe që lidhen me shëndetësinë në përgjithësi, sidomos me AHQ-në (Kujdesi Shëndetësor i çashtëm dhe cilësor) prej së cilës jemi pëfitues me pajisje mjekësore, EKG dhe aparat për laborator, paisje mjekësore për mjekësinë familjare, dhoma për këshillime e cila është në përfundim që në muajin janar do të funksionalizohet.

Me Kolegjiunin e drejtorëve të SHMS të Asociacionit të Komunave kemi pas takime e rregullta.

Kemi realizuar dy takime me përfaqësues të KFOR-it për çështje të shëndetësisë.

Takime me zyrtar të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për tema të buxhetimit dhe kostimit të shërbimeve sociale dhe blerjen e shërbimeve sociale nga ofruesit e këtyre shërbimeve.

Lëshuarja e aplikacioneve për shërim jashtë vendit, në bazë të kërkesave të palëve.

Janë lëshuar vërtetime ne bazë të kërkesave të palëve për familjarët e tyre të vrarë në luftë, të zhdukurve e të plagosurve etj.

Kemi pasur takim me përfaqësuesit e 'Institutit Gap', tema rreth ecurisë së ndarjes së subvencioneve për vitin në fjalë.

Nga të gjitha kërkesat që u janë drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjithësejt janë; 156 kërkesa. Prej këtyre kërkesave 45 kërkesa janë të apovuara, ndërsa 111 kërkesa të refuzuara.

DSHMS gjatë këtij viti ka bërë funizime dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së , QPS dhe Shtëpisë së pleqëve si më poshtë:

1. Furnizim me material ampullar-----	6,857.70€
2. Furnizim me material laboratorik-----	2,798.40€
3. Furnizim me gjinekologjik-radiologjik-----	1,199.90€
4. Furnizim me material stomatologjik-----	2,643.50€
5. Furnizim me material administrative shënd.-----	1,700.00€
6. Furnizim me material administrative-----	1,354.15€
7. Furnizim me material higjienik -----	2,000.00€
8. Furnizim me material higjienik -----	1,500.00€
9. Furnizim me material higjienik -----	499.96€
10. Karburante për vetura-----	3,621.17€
11. Regjistrim i automjeteve-----	1,336.49€
12. Furnizim për zyre-klima dhe servisim-----	1,515.00€
13. Furnizim me dru-----	1,750.00€
14. Shërbime për aparat fotokopjues-----	235.67€
15. Shërbime të fotokopjes dhe shërbime tjera-----	1,000.00€
16. Subvencione-----	15,387.00€
17. Ndërtimi i objektit ndihmës në QKMF-----	51,343.66€
18. Inventar shëndetësor për QKMF-----	5,930.00€
19. Renovimi në QKMF dhe infra.përcjellëse-----	11,878.03€
20. Renovimi në QKMF dhe infra.përcjellëse-----	2,941.03€
21. Para të gatshme -----	1,000.00€
22. Furnizim me karburant pëe nxemje QPS-----	483.50€
23. Pagesa e rrymë elektrike-----	16,984.18€
24. Pagesa e shpenzimeve të ujit-----	4,400.00€
25. Mbeturina-----	1,937.42€
26. Telefon-----	498.43€

Raporti nga QKMF-ja

Shërbimi shëndetësor ka funksionuar gjatë 24 orëve, pa ndonjë problem të theksuarëë Gjatë kësaj periudhe kanë qenë 81107 vizita shëndetësore.

Gjatë kësaj kohe Këshilli Drejtues i QKMF-së ka vazhduar me marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj. Departamenti i Mjekësisë Familjare- Sektori i Mjekësisë Familjare

Dhoma e regjistrimit

Gjatë vitit dhoma e regjistrimit ka funksionuar jashtëzakonisht mirë. Në dhomën e regjistrimit është bërë regjistrimi i palëve në vazhdimësi, në protokole të mjekëve, hapja e fletëzës së SISH-it, pagesa e participimit për shërbimet. Infermierët të cilat punojn në këtë vend janë ndërruar me sistem të rrotacionit mujor.

Triazhimi - Në dhomën e triazhimit janë menaxhuar kartelat. Po ashtu është bërë matja e TA, janë dhënë këshilla konform strategjisë së kujdesit parësor shëndetësor. Në këtë dhomë përcillen të sëmurët me sëmundje kronike në vazhdimësi dhe po ashtu ekzistojn protokolet për evidentimin e sëmundjeve kronike që janë sëmundje me prevalencë të lartë në territorin e Komunës tonë, në bazë të cilëve protokole është punuar në vazhdimësi raporti lidhur me referimet dhe sëmundjet kronike .

REFERIMET

JANAR-DHJETOR 2017

QKMF –Obiliq		Nr. i referimeve <u>PËR KONSULTI ME</u> në kujdesin dytësorë	Nr. i referimeve <u>NË DIAGNOSTIK ËN</u> e kujdesit dytësorë	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin dytësorë	Numri i përgjithshëm i vizitave mjekësore	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin dytësorë
Njësia	Departmenti					
QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	4285	490	4775	34684	13.7%
QKMF Obiliq	Emergjenca	1874	0	1874	14310	13%
QKMF Obiliq	Pediatria	406	172	578	12053	4.79%
QKMF Obiliq	Gjinekologjia	32	96	136	1451	9.3%
QKMF Obiliq	Shëndeti oral	155	318	473	4459	10.6%
QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	538	137	675	3672	18.3%
QMF	Shëndeti Oral	27	0	27	362	7.4%

Millosevë						
AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	229	6	235	2077	11.3%
AMF Siboc	Mjekësi Familjare	312	96	408	2369	17.2%
AMF Palaj	Mjekësi Familjare	0	0	0	0	0%
AMF-Shipitullë	Mjekësi Familjare	0	0	0	0	0%
QMF Plemetin	Mjekësi familjare	0	0	0	4461	0%
AMF.B.Mofc	Mjekësi familjare	0	0	0	1209	0%
		7858	1315	9181	81107	11.3%

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për sëmundjet masive jo infektive për periudhën gjashtë mujore JANAR-DHJETOR 2017

Të sëmundjeve masive jo-infektive,

1. F00, F04, F05, F09, F20, F30, F31, F32.3, F33, F22, F29, F84, G71 (shëndetit mental)
2. E10-E14, (sëmundjes së sheqerit)
3. I00-. I02, I20, I21, I24, I25 (sëmundjeve kardiovaskulare)
4. N05 (nefropatit) N03, N04, N05, N10, N18
5. J42, J45, J47, (sistemit respirator)
6. D65-D69, C- (sëmundje malinje,

Sëmundjet	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve të përsëritura	Totali
I10	986	335	1321
I20-I25	38	1	39
E10-E14	244	41	285
J42,J45,J47	46	2	48
N03,N04,N05,N10,N18	8	2	10
F00-F48	15	0	15
Sëmundjet malinje	26	4	30
Numri i referimeve në nivelin sekondar	7858		
Numri i referimeve në	1315		

diagnostikë			
Totali i pacientëve	81107		

Sektori i Shëndetit publik- Nga sëmundjet ngjitëse në periudhën janar-dhjetor 2017 janë raportuar nga mjekët këto sëmundje:

Nr	Sëmundja	Raste
1	Pneumonia	492
2	Diare	1753
3	Variqellë	136
4	Dyshim në grip	503
5	Dyshim në parotit	3
6	Dyshim në tularemi	0
7	Dyshim në tuberkuloz	0
8	Dyshim në verdhëz	0
9.	Dyshim në fruth	29

Janë përcjellë sëmundjet ngjitëse të raportushme si dhe është bërë referimi i tyre në IKSHPK si raport javor. Gjatë periudhës janar- dhjetor në shërbimin e vaksinimit janë vaksinuar këto kategori:

Nr	Grupmosha	Numri i të vaksinuarve
1	Fëmijët e vaksinuar sipas grupmoshave	2851
2	Lëndime	259
3	Vaksina e Gripit	1242
4	Femijet REA	209
5	Shërbime tjera	61
	Totali	4622

Njësia e SISH-it në përbërje të vazhdueshme nga tre operatorë, organizuan furnizuan, pranuan, regjistruan fletëzat e SISH-it. Sasia e fletëzave kompjuterike është në nivel të kënaqëshëm. Departamenti i administratës këtë vit ka funksionuar pa ngecje. Është raportuar në baza ditore, javore, mujore, është mbajtur evidenca rreth vijimit të punëtorëve.

Njësia për shërbime teknike- Sa i përket furnizimit me material higjienik ka qenë i kënaqëshëm. Higjiena ka qenë në nivel të duhur me vërejtje të kohëpasëkohëshme.

Barnatorja qendrore- Furnizimi me barëra brenda kësaj periudhe nuk ka qenë i kënaqëshëm. Kemi mungesë të madhe me barna nga lista esenciale. Barërat që kanë arritur në barnatore

janë shpërndarë vazhdimisht nëpër QMF dhe AMF. Kërkesat për barëra nga lista esenciale janë dorëzuar në korporatë me rregull. Po ashtu vlenë të përmendet se furnizimi me insulinë ka qenë në nivel të kënaqshëm.

EDUKIMI SHËNDETËSOR

Komisioni për Edukim dhe promovim shëndetësor në Obiliq gjatë vitit 2017 organizoi aktivitete të ndryshme, siç janë:

- ❖ Prezentimi i punës një vjeçare në komunitet, respektivisht prezentimi i të dhënave në takim me qytetarët e komunës, që nënkupton sëmundshmërinë dhe mundësinë e parandalimit. Takim i organizuar nga KK Obiliq.
- ❖ Më. 06/02/2017 (meqë 04 shkurt ishte ditë e Shtunë) u shënua 'Dita Botërore Kundër Kancerit' me ç'rast në qendrën rekreative të pensionistëve u mbajt një ligjeratë nga ekipi për edukim dhe promovim shëndetësor për vizitorët e rastit.
- ❖ Më. 24/03/2017 u shënua 'Dita botërore e Tuberkulozës' me ç'rast në shkollat e mesme të larta në gjimnazin "17 Shkurti" dhe shkollën teknike "Ismail Dumoshi" u mbajt një ligjeratë me temën "Tuberkulozi" nga Ekipi për edukim dhe promovim shëndetësor për pacientët e rastit. Po ashtu u shpërndan lifleta dhe postera.
- ❖ Prej datës 24 prill filloi shënimi i "Javës së imunizimit" grupi i fokusimit ka qenë komuniteti REA në Plemetin. Me këtë rast vaksinimi ka qenë në nivel shumë të kënaqshëm, 22 fëmijë të këtij komuniteti janë vaksinuar.
- ❖ Gjatë këtij muaji filloi realizimi i "Vizitave në shtëpi për kujdesin për nëna dhe fëmijë deri në moshën tre vjeçare" mbështetur nga MSH, QZHMFK dhe UNICEF.
- ❖ Më. 17 Maj në QKMF u shënua dita 'Botërore e Hipertensionit' me ç'rast grupit të rastit prej 13 prsonave iu mbajt ligjeratë me temën; "Hipertensioni arterial".
- ❖ Prej muajit qershor në vazhdimësi mbahen ligjerata të organizuara nga KOPF dhe AQH për vaksinim promovim shëndetësor, të cilat janë të fokusuara në komunat e Lipjanit dhe Fushë-Kosovës.
- ❖ Në fillim të muajit gusht u shënua java për promovim të gjdhënjes, ku me paciente të rastit gjatë tërë javës u mbajtën ligjerata rreth rëndësisë dhe teknikave të gjdhënjes.
- ❖ Më. 29/09/2017 u shënua 'Dita Botërore e Zemrës', me ç'rast pacientëve të rastit iu mbajt ligjeratë rreth Sëmundjeve kardiovaskulare dhe në Shkollën "Ibrahim Rugova" në Obiliq u mbajtën dy ligjerata "Hipertensioni" dhe "Sëmundjet e sistemit kardiovaskular".
- ❖ Me 15 Nëntor u shënua Dita Botërore e Diabetit, në Plemetin në bashkëveprim me organizatën "Balkan sunflower" grave të komunitetit Rom dhe Ashkali iu mbajtë ligjeratë rreth Diabetit dhe iu ofrua matja e glikemisë falas.
- ❖ Me 01/12/2017 u shënua Dita botërore e sëmundjeve AIDS. Ekipi për ESH mbajti dy ligjerata në 'Sh.f Ibrahim Rugova' me nxënës të klasave të nënta.

Punët në komunitet;

Në kuadër të bashkëpunimit me AQH /KOPF gjatë muajit shtator janë mbajtur 4- trajnime me temën: Diarrea(barkqitja) për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas:

09/09/2017 në Nekofc- komuna e Drenasit

12/09/2017 në Glllogoc- komuna e Lipjanit

16/09/2017 në Baic - komuna e Drenasit

17/09/2017 në Ribar i Madh – komuna e Lipjanit.

Më datën 25/10/2017 në kuadër të bashkëpunimit me AQH /KOPF në SHMU “ Pandeli Sotiri” në Obiliq është mbajtur trajnime në komunitet me temën: Diarrea (barkqitja).

Më 18 nëntor 2017 në kuadër të organizatës KOPF e mbështetur nga AQH Dr. Rejhane Zhushi-Musliu ka mbajtur trajnim ne komunitet me temën: „ Hypertension arterial” në objektin Katana në Obiliq.

Më 23 nëntor 2017 në obejktine SHMU në Dardhishtë- Obiliq është mbajtur trajnim me komunitet me temën: ‘Hypertension arterial’ (Dr.Rejhani).

Më 27 nëntor 2017 në objektin e shkollës në fshatin Plemetin me komunitetin Ashkali Rom, Egjiptas eshte mbajtur trajnimi me temën: ‘Diarea-barkqitja’.

Më. 29 nëntor 2017 janë mbajtur 2- trajnime me komunitetin REA në fshatin Plemetin me temën: ‘Diarea-barkqitja’.

Më 30 nëntor 2017 në objektin e shkollës në Plemetin me komunitetin REA eshte mbajtur trajnimi me temën: ‘Hypertension’.

Më 29 dhjetor 2017 janë mbajtur 2- trajnimi me komunitetin REA në fshatin Plemetin Organizata jo qeveritare ‘Health For All’, me temën:

Hypertension – me 25 pjesëmarrës të komunitetit REA.

Diabeti – me 25 pjesëmarës të komunitetit REA.

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF NË PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2017

Nr	QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE OBILIQ	Numri i pacientëve	Total shërbime
1.	QKMF OBILIQ	66957	162404
2.	QMF MILLOSHEVË	4034	10412
3.	QMF PLEMETIN	4461	8135
4.	AMF BREZNICË	2077	3605
5.	AMF SIBOVC	2369	6124
6.	AMF B.MOFC	1209	3868
7.	AMF PALAJ	Nuk punon	
8.	AMF SHIPITULLË	Nuk punon	
9.	TOTALI:	81107	194 548

DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

	SEKTORI I MJEKËSISË FAMILJARE	
1.	Numri i pacientëve	34684
2.	Intervenca	10904
3.	Lidhje plagesh	1528
4.	Raste urgjente	1530

5.	Vizita shtëpiake me mjek	262
6.	Vizita shtëpiake vetëm me infermier	562
7.	Infuzione	4820
8.	Inhalime	377
9.	Vendosje + largimi i kateterëve	87
10.	Pastrimi i veshëve	219
11.	Totali i shërbimeve të ofruara	18759

SEKTORI KONSULTATIV

	NJËSIA E PEDIATRISË	
1.	Numri i pacientëve	12053
2.	Raste urgjente	142
3.	Dhënje e inekcioneve	457
4.	Inhalime	1632
5.	Infuzione	243
6.	Lidhje pastrim	514
7.	Referime	528
8.	Këshilla pediatrike	120
9.	Totali i shërbimeve të ofruara	2966
	NJËSIA E GJINEKOLOGJISË	
1.	Numri i pacientëve	1451
2.	Nr i vizitave gjinekologjike	1093
3.	Nr i vizitave obstetrike	372
4.	Referime	83
5.	Kontraceptive	79

6.	Këshilla	175
7.	Gravid teste	68
8.	Ex.i pejve+lidhje	96
9.	Kondoma	3368
10.	KAN	1641
11.	Totali i shërbimeve të ofruara	5427

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

	NJËSIA E SISH-IT	
1.	Numri i pacientëve të regjistruar	41435

	NJËSIA E VAKSINIMIT DHE IMUNIZIMIT	
1.	Numri i pacientëve të vaksinuar	4622

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

	KUJDESI EMERGJENT	
1.	Numri i pacientëve	14310
2.	Intervenca	5747
3.	Lidhje dhe pasrim i plagës	398
4.	Infuzione	1622
5.	Inhalime	614
6.	Raste urgjente	3477
7.	Vizita shtëpiake me mjek+v.sh me infermier	1103 /393
8.	Vendosja + Largim i kateterëve	48
9.	Referime në kujdesin tretësor	1874
10.	Referime përshkrime Z-76	0
11.	Referime ne diagnostikë	0
12.	EKG	6
13.	Totali i shërbimeve të ofruara	13408

SEKTORI I SHËNDETTIT ORAL

	SHËNDETTI ORAL	
1.	Numri i pacientëve	4459
2.	Pllomba amalgam	172
3.	Heloipllomba	295
4.	Depulpin	286
5.	Endometazon	101
6.	Kalcium hidroksid	336
7.	Drenazha	534
8.	Sol.klumsi	843
9.	Ex.i perhershëm	369
10.	Ex.qumeshtit	677
11.	Cavit	750
12.	Shperlarje NaCl	546
13.	Jodoform klumsi	163
14.	Alveozhill	120
15.	Kiretazh e gjepave paradontal	45
16.	Termokauterizim	8
17.	Largim i polipit	39
18.	Largim i depozitimeve te forta	24
19.	Zink oksid	6
20.	Vendosja e kunjës pulpare	11
21.	Gellatamp	41
22.	Guttaperka	98
23.	Fosfat pllomba	496
24.	Incizione	36
25.	Tamponime të plagës	1001
26.	Terapi me antibiotik	228
27.	Referime	155
28.	Referime në RTG	318
29.	Largimi i kontaktit traumatik	36
30.	Polirim i pllombës	1
31.	Glassjonomer cement	26
32.	Trisan pastë	1

33.	Vizita stomatologjike (Këshilla)	493
34.	Calcigel	2
35.	Përpunim i plagës	2
36.	Ekstirpim vital	10
37.	Dekortikim selektiv	2
38.	Flow pllombë	2
39.	Lidokainë ampullë	94
40.	Totali i shërbimeve të ofruara	7919

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

	LABORATORI	
1.	Numri i pacientëve	5706
2.	SE	2537
3.	Hemogram	1903
4.	Le	911
5.	Glikemi	2680
6.	Urea	1438
7.	Kreatinina	216
8.	Kolesteroli	1858
9.	Trigliceridet+fibrinogjen	2056/13
10.	Urina	4387
11.	Totali i analizave të punuara	23705

	RTG	
1.	Nr. pacientëve	2509
2.	Nr. i Egzaminimeve në RTG	4223
3.	Skelet	1975
4.	Trakt respirator	623
5.	Abdomen -urotrakt	49
6.	Totali i shërbimeve	4223

	BARNATORJA	
1.	Nr. pacientëve	4491
2.	Nr. i recetave	6053
3.	Totali i shërbimeve	4491

	VIZITAT SHTËPIAKE PËR NËNËN DHE FËMIUN DERI NË PESË VJET	
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	78
2.	Nr i fëmijëve të përfshirë në vizitë	59
3.	Nr i shtatëzënave të përfshirë në vizitë	19
4.	Totali i shërbimeve	78

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

	QMF MILLOSHEVË	Total pacienta
1.	Mjeku familjar	3672
2.	Intervenca + Z-76	1692
3.	Lidhje dhe pasrim i plagës	647
4.	Infuzione	174
5.	Inhalime	105
6.	Raste urgjente	57
7.	Vizita shtëpiake me mjek+v.sh me infermier	5
8.	Vendosje + largim i kateterit	13
9.	Pastrim i veshëve	13
10.	Stomatologji	362
11.	Referime +Z-76	538
12.	Referime në diagnostikë dytësore ECHO	137
13.	Totali i shërbimeve	6740

	QMF PLEMETIN	Total pacienta
1.	Mjeku familjare	4461
2.	Intervenca	2435
3.	Lidhje dhe pasrim i plagës	426
4.	Infuzione	432
5.	Inhalime	85

6.	Raste urgjente	22
7.	Vizita shtepiake me mjek+v.sh me infermier	296
8.	Totali i shërbimeve	3674

	AMF SIBOVC	Total pacienta
1.	Mjeku familjare	2369
2.	Intervenca	596
3.	Lidhje dhe pasrim i plagës	262
4.	Infuzione	187
5.	Inhalime	62
6.	Raste urgjente	20
7.	Vizita shtepiake me mjek+v.sh me infermier	62
8.	Vendosje + largim i kateterit	7
9.	Pastrim i veshëve	1
10.	Matja e glikemisë	7
11.	Referime në diagnostikën sekondare +Z-76	96
12.	Referime në kujdesin dytësor +Z-76	312
13.	Largimi i riqnës	44
14.	Totali i shërbimeve	3755

	AMF BREZNICË	Total pacienta
1.	Mjeku familjare	2077
2.	Intervenca	939
3.	Lidhje dhe pasrim i plagës	291
4.	Infuzione	201
5.	Inhalime	75
6.	Raste urgjente	16
7.	Vendosja dhe largimi i kateterit	0
8.	Pastrimi i veshëve	0
9.	Vizita shtepiake me mjek+v.sh me infermier	4
10.	Referime në kujdesin tretësor	81
11.	Referime (përshkrime Z-76)	138
12.	Referime në diagnostikën sekondare	6
13.	Totali i shërbimeve	1522

	AMF B.MOVC	Total pacienta
--	------------	----------------

1.	Mjeku familjare	1209
2.	Intervenca	773
3.	Lidhje dhe pastrim i plagës	1717
4.	Infuzione	75
5.	Inhalime	94
6.	Raste urgjente	0
7.	Vendosja dhe largimi i kateterit	0
8.	Vizita shtëpiake me mjek+v.sh me infermier	471
9.	Totali i shërbimeve	2659

RAPORT I TË HYRAVE PËR PERIUdhËN KOHORE
JANAR-DHJETOR 2017

Data e dorëzimit	Shuma	Vendi ku janë dorëzuar
TOTALI	20777.50E	NLB

RAPORT I SHPENZIMIT TË KARBURANTEVE PËR PERIUdhËN KOHORE
JANAR-DHJETOR 2017

Periudha	Benzin		Dizel		
JANAR-DHJETOR			8652.4 litra		

Vështërsitë me të cilat jemi ballafaquar gjatë këti viti ishin:

1. Mosfunksionimi i AMF-Palaj-ka përfunduar renovimi i objektit (ka mungesë të inventarit).
2. Mosfunksionimi i përkohëshëm i AMF-Shipitullë.
3. Mos furnizimi i saktë me reagencë në laborator.
4. Pa mundësia e kyqjes së aparatit të ri në laborator.
5. Mos përdorimi i rregullt i kartelave shëndetësore.
6. Buxheti jo i mjaftueshëm për funksionalizim të aparaturës (ekg-së).
7. Mungesa e uniformës dhe pjesëve tjera mbrojtëse në RO.

Raporti i QPS-së

Gjat vitit 2017 shërbimet sociale dhe familjare janë kryer përmes aktiviteteve të përditshme në kuadër të kompetencave dhe përgjegjesive që ka QPS-ja

Skema e Ndhmës Sociale

Skema e Ndhmës Sociale në Obiliq është ngritur në vitin 2000, ndërsa komplet me stafin Qendra ka filluar punën në shkurt të vitit 2002. Është një ndër format e mbrojtjes sociale në mënyrë që të lehtësohet varfëria me anë të ndihmave sociale për të varfërit dhe familjet në gjendje të nevojës sociale. Skema e ndihmës sociale është një mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet në varfëri. Kjo ndihmë e përkohshme financiare u ofrohet familjeve të cilat plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuar me Ligjin Nr.2003/15 për

Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, një numri të caktuar të udhëzimeve administrative dhe në bazë të buxhetit vjetor që Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë për këtë skemë.

Struktura organizative e Skemës së Ndhmave Sociale

Struktura e e Ndhmës Sociale është e organizuar në këto nivele:

Niveli qendror: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS),

Divizioni i Ndhmave Sociale (DMS),

Niveli lokal: Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS).

Qendra për Punë Sociale (QPS)ë

Shuma mujore e ndihmës sociale përcaktohet sipas numrit të antarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të shportës së ushqimit e cila rregullohet me akt nënligjor të nxjerrur nga Ministria. Minimalja e ndihmës sociale është 50 € ndërsa maksimalja është 150 €.

Ofrimi i ndihmës sociale gjatë vitit 2017ë

Sipas kushteve dhe kriterëve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të skemës së ndihmave sociale, ndihmën sociale për periudhën raportuese janar-dhjetor 2017e kanë realizuar numri i familjeve si më poshtë:

Numri i familjeve dhe antarëve të familjeve në SNS sipas muajve për vitin 2017

Muaji	Nr.i familjeve në SNS	Anëtarët e familjes në SNS	Shuma në €
Janar	864	3.544	80,881.25 €
Shkurt	863	3.542	80,328.75 €
Mars	890	3.641	82,758.75 €
Prill	875	3.578	80,893.75 €
Maj	897	3.643	83,387.50 €
Qershor	892	3.636	81,896.25 €
Korrik	887	3.614	81,270.00 €
Gusht	875	3.580	80,740.00 €
Shtator	878	3.596	80,951.00 €
Tetor	900	3.675	82,800.10 €
Nëntor	902	3.699	82,877.50 €
Dhjetor	899	3.698	83,511.25 €
Gjithësej:			982,296.10 €

Sipas kësaj rezulton se në periudhën janar-dhjetor 2017 numri i familjeve në SNS është rritur, Gjatë vitit 2017 kemi pasur këto: Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje .

Muajt	Aplikime	Riaplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	7	111	6	8
Shkurt	9	134	8	14
Mars	7	174	9	11
Prill	11	158	9	9

Maj	9	86	7	4
Qershor	6	61	6	20
Korrik	8	88	6	3
Gusht	7	77	4	21
Shtator	9	104	10	7
Tetor	7	118	6	5
Nentor	11	115	5	12
Dhjetor	11	98	5	5
Gjithësej:	102	1258	81	119

Lëndët e Komisionit Mjekësor gjatë vitit 2017			
Muajt	Lëndë K.mjekësor të Aprovuara	Lëndë e K.mjekësor të Refuzuara	Gjithësej
Janar	35	1	36
Shkurt	41	0	41
Mars	46	3	49
Prill	42	1	43
Maj	42	1	43
Qershor	33	0	33
Korrik	42	1	43
Gusht	28	4	32
Shtator	17	3	20
Tetor	40	7	47
Nëntor	49	3	52
Dhjetor	33	1	34

Kërkesa për ndihma emergjente nga DMS-ja për vitin 2017 kanë qenë 13, prej tyre 10 të aprovuara dhe 3 të refuzuara.

SHHBK "Nëna Terezë" në Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kemi bërë shpërndarjen e 100 familje përfituese me veshmbathje me datën 24.02.2017 pranë QPS-së në Obiliq.

Organizata Human Appeal Int ka bërë shpërndarjen e batanijeve për familjet skamnore, familjet e përzgjedhura nga QPS në Obiliq 16 familje, me 40 batanije. Shpërndarja është bërë me datën 24.01.2017.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me një grup të studentëve në mënyrë humanitare, në bashkëpunim edhe me puntorët e QPS-së ka bërë shpërndarjen me nga dy pako veshëmbathje

për 50 familje në varfëri të skajshme. Ky aktivitet humanitar është zhvilluar më datë 06.02.2017.

Kanë qenë gjithsej 7 kërkesa për familjet me gjendje të rëndë ekonomike e sociale. Njësia e Kontrollit dhe Mbrojtjes ka bërë kontroll në Skemën e Ndihmës Sociale në QPS në Obiliq që nga data 30.05.2017 deri më datën 07.06.2017.

Kemi pasur një donator vullnetar i cili ju ka ndihmuar dy familje në vlerë nga 100 €, me gjëra ushqimore me datën 20.06.2017.

Me gjithë angazhimin që kemi pasur në punët obligative profesionale na janë paraqitur pengesa teknike siç janë mungesa e kompjuterëve, mungesa e veturës etj.

Njësia e Kontrollit dhe Mbrojtjes (NJKM) për Skemën e Ndihmës Sociale ka kontrolluar lëndë të shfrytëzuesve të ndihmave sociale dhe ka bërë verifikimin e familjeve në QPS-Obiliq nga data 30.05.2017 deri më datën 07.06.2017,

Auditim i brendshëm nga MPPS-ja në QPS-Obiliq ka bërë kontrollë prej kontrollë dy javore. Nga SNS-ja janë lëshuar 124 vërtetime për vitin 2017.

Raport vjetor i Shërbimeve Sociale për vitin 2017 QPS-së në Obiliq

Në Qendrën për Punë Sociale në Obiliq gjatë këtij viti kemi kryer këto shërbime për qytetarët e Komunës sonë. Në Sektorin e Shërbimeve Sociale janë kryer këto shërbime :

1. Fëmijë pa kujdes prindëror - 16 raste,
2. Kërkesë për strehim familjar- 11 raste,
3. Fëmijë të keqëtrajtuar - 6 raste,
4. Të miturit në konflikt me ligjin - 65 raste,
5. Martesa e të miturëve - 3 raste,
6. Kërkesë për këshilla martesore - 19 raste,
7. Klient me probleme familjare -18
8. Viktima të dhunës në familje -12
9. Persona me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeçare - 11 rast,
10. Fëmijë me aftësi të kufizuara- 5 raste,
11. Vërtetime për armë-mbajtje - 27
12. Vërtetime për punësim- 53
13. Vërtetime për rregullim të dokumentacionit të SNS-së -15
14. Vërtetime për humbje të shtetësisë- 49.

Gjithashtu lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale janë ofruar 390 aktivitete të ndryshme të kategorive sociale. Kemi pasur bashkëpunim të ndërsjelltë me organizata qeveritare dhe jo qeveritare, siç janë; 'Ofami', 'UNICEF', po ashtu kemi pasur bashkëpunim të mirë me MPPS-në, Komunën, Policinë e Kosovës etj.

DREJTORIA PËR EKONOMI FINANCA DHE ZHVILLIM

Buxheti	
Paga dhe medietje	3,664,936.00
Mallra dhe sherbime	367,452.00
Shpenzime komunale	123,000.00
Subvencione dhe transfere	138,799.00
Shpenzime kapitale	1,766,829.00
TOTALI:	6,061,016.00

Projekti	Buxheti		Total Buxheti 10+21+22	Shpenzimi 10	21		Total shp. 10+21+22	Te Lira 21	Te lira 22	Total te lira
